

1 E hënë, 27 janar 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.06

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Mirëmëngjesi, të gjithëve. Vërej që të akuzuarit janë të
13 gjithë të pranishëm në sallën e gjyqit sot.

14 Fillimisht kemi pranuar emaillet e ekipeve të Mbrojtjes
15 lidhur me shënimin përgatitor që janë dorëzuar gjatë fundjavës
16 lidhur me dëshmitarin e dytë. Mbrojtja tani e ka informacionin
17 në fjalë. Do të dëgjojmë parashtimet lidhur me këtë pikë kur
18 të përfundojmë me këtë dëshmitar sot. Shpresoj, uroj të
19 mbarojmë sot dhe pastaj do të trajtojmë kundërshtimet që mund
20 të keni dhe do ju jepet mundësia që të shqyrtoni dokumentet në
21 hollësi.

22 Përpara që të thërrasim dëshmitarin në sallë, konstatojmë
23 në procesverbal se përmes një emaili të datës 24 janar 2025
24 Trupi Gjykses miratoi lejen, autorizoi ZPS-në që të
25 zëvendësojë dokumentet mbështetëse të ERN 122430 deri në

1 102442-AT të përdorura me Dëshmitarin W04874 dhe me numër të
2 shënuara për identifikim me numrin provizor P01990 me
3 përkthimin e saktë në shqip.

4 Znj. Sekretare, na kaloni në seancë private.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do

6 të fillojmë me dëshminë tuaj, që mendohet se do të zgjasë

7 vetëm sot, ditën e sotme. Në fillim ua bën pyetjet Prokuroria,

8 më pas mund t'ju bëjnë pyetje Ekipet e Mbrojtjes. Por mund të

9 kenë pyetje dhe anëtarët e Trupit Gjykues.

10 Prokuroria ka kërkuar dy orë për pyetjet. Mbrojtja një

11 orë e 20 minuta për kundërpvetjet. Inkurajoj palët të jenë sa

12 më të kujdesshëm në shfrytëzimin e kohës. Trupi Gjykues mund

13 të lejojë pyetje plotësuese nëse përmbushen kushtet.

14 Dëshmitar, përgjigjuni qartë me fjali të shkurtra. Nëse

15 nuk e kuptoni një pyetje kërkon që pyetja të përsëritet ose

16 thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që ta sqarojmë. Gjithashtu na

17 thoni ku e bazoni ju faktet rrethanat për të cilat do t'ju

18 bëjnë pyetje.

19 Në qoftë se Prokuroria ju kërkon të përmendni korrigjimet

20 që i keni bërë deklaratës suaj, ju kujtoj se do të thoni me zë

21 për procesverbal se deklarata me shkrim, bashkë me korrigjimet

22 përkatëse pasqyron saktësisht dëshminë tuaj.

23 Gjithashtu flisni ngadalë, flisni pranë mikrofonit edhe

24 prisni pesë sekonda përpara se të përgjigjeni.

25 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në këtë Gjykatë, nuk

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Wyler

Faqe 18

1 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
2 jashtë ambienteve të Gjykatës. Nëse ndokush jashtë Gjykatës ju
3 bën pyetje për dëshminë tuaj, na informoni.

4 Ju lutem ndërprisni fjalën nëse ua kërkoj unë, si dhe
5 ndërprisni fjalën nëse e shihni që unë ngre dorën. Sepse mua
6 do më duhet të jap një udhëzim.

7 Në çdo moment që keni nevojë për pushim na informoni dhe
8 do të bëjmë organizimin përkatës.

9 Dëshmitar, do të fillojmë me pyetjet e Prokurorisë që
10 janë ulur në të majtën tuaj. Dëgjojini me vëmendje.

11 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

12 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

13 Pyetje nga znj. Wyler:

14 ZNJ. WYLER: [Përkthim]

15 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Ne jemi takuar bashkë përpara.
16 Quhem Eva Wyler dhe jam ndihmësprokurore në Prokurori. Unë do
17 t'ju bëj pyetjet për orët në vijim.

18 Ju lutem na e thoni emrin dhe mbiemrin.

19 PË. Mbiemri është Gasior, emri është Marek, emri kristian
20 është Marek.

21 PY. Datëlindja?

22 PË. Kam lindur më 20 qershor 1946.

23 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Do lutesha të vendosni në ekran
24 materialin që mban numrin 103409-103410. Dhe një herë
25 materialet që do kërkoj të shfaqen sot nuk janë për publikun.

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Wyler

Faqe 19

1 PY. Dëshmitar, a është ky jetëshkrimi juaj?

2 PË. Po, është jetëshkrimi im.

3 PY. A është e saktë përmbajtja mesa keni ju dijeni?

4 PË. Po. Përmbajtja e jetëshkrimit tim është e saktë.

5 PY. A ka ndonjë gjë që doni të shtoni?

6 PË. A mund ta shoh ju lutem edhe pjesën e poshtme?

7 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në faqen
8 tjetër.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Përmbajtja në CV, në jetëshkrim
10 është e saktë.

11 ZNJ. WYLER: [Përkthim]

12 PY. Faleminderit.

13 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë
14 pranimin e jetëshkrimit dhe njësoj si me rastin e dy
15 dëshmitarëve të tjerë dhe në kuadrin e vendimit tuaj F02787,
16 propozojmë që t'ju jepet numër provizor dhe të vendoset në
17 fund për pranimin e materialeve lidhur me këtë dëshmitar.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja ka
19 diçka për të thënë lidhur me këtë? Apo t'i japim numër
20 provizor.

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Jo, mund t'i jepni numër provizor.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Jepini një numër provizor.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jetëshkrimi do të marrë
25 numrin provizor P002001 dhe klasifikimi është konfidencial.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ju lutem të vendosni në ekran

3 materialin që mban numrin ERN 103427-103470.

4 PY. Dëshmitar, në të djathtë të ekranit shihni një faqe që ka

5 emrin tuaj edhe ka një datë që përmendet 7 tetor 2021. A e

6 keni përgatitur ju këtë raport?

7 PË. Po, është nënshkrimi im.

8 PY. A është raporti që keni përgatitur ju ky?

9 PË. Po, unë e kam shkruar këtë raport.

10 PY. A e përgatitët këtë raport pasi u kishte dorëzuar një

11 letër me udhëzime ZPS-ja?

12 PË. Po, unë e kam shkruar këtë raport në përputhje me letrën

13 që më ka dërguar ZPS-ja.

14 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ju lutem të vendoset në të majtë

15 të ekranit materiali që mban numrin 102443-102471.

16 PY. Në të majtë të ekranit shihni udhëzimet që u ka dërguar

17 Prokuroria dhe mban datën 30 korrik 2021. Pra, a e përgatitët

18 ju raportin në bazë të letrës me udhëzimet që shihni në të

19 djathtë të ekranit?

20 PË. Po. Kjo letër ka qenë baza e raportit.

21 PY. A ju kujtohet që përkrah letrës me udhëzimet ju dhamë

22 edhe disa materiale mbështetëse?

23 PË. Po, kam marrë dokumente, kam marrë disa dokumente,

24 ndonëse nuk më kujtohen saktësisht më për çfarë dokumentesh

25 bëhet fjalë.

1 PY. A është e vërtetë që letra me udhëzime përmban pyetje
2 konkrete lidhur me dokumentet që u ka dhënë ZPS-ja?

3 PË. Po, letra kishte pyetje konkrete.

4 PY. A ju kujtohet që i lexuat dhe një herë dokumentet që
5 përmenden në letrën me udhëzime edhe bërë disa referenca në
6 aktekspertizën tuaj, ju referuat në aktekspertizën tuaj?

7 PË. Letra lidhej me autopsitë që kam kryer unë.

8 PY. Sa i takon pyetjes për raportet e autopsisë, a i
9 përmendët ju konkretisht këto raporte në aktekspertizën tuaj?

10 PË. Po, ju përgjigja pyetjeve konkrete që lidheshin me
11 autopsitë konkrete.

12 PY. Aktekspertiza a përmban opinionin tuaj të pavarur lidhur
13 me aspektet që trajtohen në të?

14 PË. Po, është opinionimi im dhe është vetëm opinionimi im.

15 PY. A ju kujtohet që ju patët mundësinë t'i lexonit dhe një
16 herë materialet edhe të bënit korrigjime dhe sqarime në këtë
17 aktekspertizë?

18 PË. Po, ka qenë e mundur. E pata këtë mundësi.

19 PY. A ju kujtohet që ju thatë se nuk kishit asnjë korrigjim
20 apo sqarim për raportin tuaj?

21 PË. Nuk më kujtohen të gjitha hollësitë. Doni të më tregoni
22 një raport konkret, ju lutem?

23 PY. Jo, e kam fjalën për seancën që patëm bashkë javën e
24 kaluar kur ju dhamë mundësinë t'i lexonit dhe një herë
25 raportet dhe të bënit korrigjime a sqarime. Dhe unë po ju

1 pyes, a ju kujtohet që ju thatë se nuk ishte nevoja as për
2 korrigjime as për sqarime?

3 PË. Nëse më kujtohet drejt, disa korrigjime shumë të vogla.

4 PY. Nuk e kuptoj për çfarë e keni fjalën? Nuk e kam fjalën
5 tani për autopsitë që keni kryer. E kam për raportin që është
6 në të djathtë të ekranit tuaj fjalën. Pra, për këtë raport, a
7 është e vërtetë që nuk kishit korrigjime apo sqarime?

8 PË. Raportin e kam përgatitur unë, e kam nënshkruar unë që do
9 të thotë është okej ashtu siç është.

10 PY. A ju kujtohet atëherë që ne u takuam bashkë javën e
11 kaluar dhe unë ju pyeta për raportin që është në të djathtë të
12 ekranit, raport, pra, që e kishit përgatitur për këtë lëndë,
13 unë ju pyeta a doni t'i bëni ndonjë korrigjim, a keni ndonjë
14 sqarim për t'i bërë këtij raporti dhe ju thatë jo, nuk ka
15 nevojë?

16 PË. Po për cilin raport e keni fjalën? A mund të ma tregoni
17 raportin?

18 PY. Po është raporti në të djathtë të ekranit.

19 ZNJ. WYLER: [Përkthim] I lutem Sekretarisë ta çojë deri
20 në fund faqen që ta shihni të plotë.

21 PY. A e kuptoni për cilin raport e kam fjalën? Është raporti
22 i përgjithshëm që keni përgatitur ju. Dëshmitar, nuk është
23 nevoja ta lexoni. Unë thjesht po ju pyes a e njihni këtë
24 raport. A është raporti juaj? E kuptoni për cilin raport e kam
25 fjalën?

1 PË. Po, po e kuptoj për cilin raport bëhet fjalë.

2 PY. Faleminderit. Edhe unë po ju pyes tani që a e mbani mend
3 kur ju pyeta unë a do t'i bësh korrigjime raportit, ti the që
4 nuk ishte nevoja për t'i bërë asnjë korrigjim?

5 PË. Po, saktë është për këtë raport është dhënë arsyeja,
6 është dhënë shkaku i vdekjes së pacientit.

7 PY. Informacioni, përmbajtja e këtij raporti në të djathtë --
8 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Shkojmë dhe një herë në faqen e
9 parë dhe një herë ju lutem.

10 PY. Pra, informacioni a është i vërtetë dhe i saktë me aq sa
11 besoni dhe keni ju dijeni?

12 PË. Përmbajtja e këtij raporti është në përputhje me
13 autopsinë.

14 PY. Raporti në tërësi, raporti ku po shihni ju, raport që
15 keni përgatitur për këtë lëndë, a është një raport që ju
16 besoni se është i saktë dhe i vërtetë me sa keni ju dijeni?

17 PË. Ky raport, autopsia është kryer për të përcaktuar shkaqet
18 e vdekjes së pacientit.

19 PY. Aktekspertiza juaj a pasqyron saktësisht atë që do të
20 thonit sërish sot nëse do t'ju bënin pyetje për të njëjtat
21 pika?

22 PË. Ky raport flet për lëndimet që janë evidentuar në kufomë
23 dhe në këtë raport është dhënë edhe shkaku i vdekjes.

24 PY. Faleminderit.

25 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Kërkojmë pranimin e letrës së

1 udhëzimeve që është me ERN 102443-102471 dhe aktekspertizën që
2 ka ERN 102427-103470. Ne kërkojmë që t'i jepet numri provizor
3 për momentin sepse Trupi Gjykues do të vendosë më vonë lidhur
4 me pranueshmërinë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
6 102443-102471 që është letra me udhëzime, do të marrë numër
7 provizor.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Letra do të marrë
9 numrin provizor P02002 dhe klasifikimi është konfidencial.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me
11 numër 1034727-103470, që është ekspertiza e 7 tetorit 2021 do
12 të marrë numër provizor.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materiali do të marrë
14 numrin P02003.

15 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kam diçka për të thënë për këtë,
16 të gjitha përgjigjet e dëshmitarit ishin në vetën e parë. Ai
17 tha se dokumenti konfirmonte gjetjet e autopsisë dhe lidhur me
18 kufomën. Por raporti është më i gjerë se kaq, nuk flet vetëm
19 për autopsinë, të sigurohemi që nuk ka ndonjë pakënaqësi në
20 fakt.

21 Z. TULLY: [Përkthim] Çështje procedurale, për saktësi të
22 transkriptit. Në faqen 23, përgjigja që ka dhënë dëshmitari në
23 rreshtin 7 në fakt nuk është përgjigje e pyetjes që i bëri
24 Prokurorja. Faleminderit.

25 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Mund ta pyesim sërish dëshmitarin

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Wyler

Faqe 25

1 nëse është nevoja nëse raporti që ka përgatitur për ZPS-në,
2 raport që mbulon disa viktima --

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjeni dhe
4 një herë pyetjen.

5 ZNJ. WYLER: [Përkthim]

6 PY. Dëshmitar, aktekspertiza që keni përgatitur ju, në vijim
7 të letrës së udhëzimeve që ju dërgoi ZPS-ja, raporti që
8 prefshin disa autopsi, disa viktima, disa certifikata
9 vdekjesh, ky raport, mesa keni ju dijeni, a është i saktë?
10 PË. Këtë raport e kam përgatitur bazuar në autopsitë që kam
11 kryer dhe përfundimet.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

13 ZNJ. WYLER: [Përkthim] ZPS-ja kërkon edhe materialet
14 burimore që lidhen me aktekspertizën e këtij dëshmitari.
15 Numrat përkatës i kemi përcaktuar në Shtojcën 1 të shënimit
16 përgatitor të dëshmitarit që mban ERN 124921-124937. Siç bëmë
17 edhe me dëshmitarët e tjerë ekspertë, Trupi Gjykses do të
18 vendosë më vonë lidhur me pranueshmërinë e këtyre materialeve
19 për shkak të vëllimit të madh që kanë. Kështu që dhe ne
20 kërkojmë që t'i jepet një numër provizor për momentin.

21 Ndërkohë mund ta heqim letrën e udhëzimeve në ekran, por
22 mbani raportin. Në raport do lutesha të shkonim në faqen
23 103439 në pjesën e dytë të faqes.

24 Ju lutem vendosni dhe përbri në ekran ERN 124921-124937,
25 faqen e fundit ju lutem, që të bëjë disa shënime dëshmitari.

1 A e verifikoni dhe një herë ju lutem faqen, ekspertiza a
2 është faqja që përfundon me 39?

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqja në ekran është
4 faqja 103439.

5 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Shkëlqyeshëm. Po, kjo.
6 Faleminderit.

7 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj një pjesë të aktekspertizës më
8 pas do t'ju bëj një pyetje. Ju keni shkruar në këtë faqe:

9 "Sipas raportit të autopsisë", "gjatë gjetjeve të
10 autopsisë":

11 "lëndime në *processus transverses* vertebra lumbar - mbase
12 *perimoret*, paravdekjes) domethënë dhe

13 "lëndim *ante-mortem* në pjesën e majtë të kërbishtesh, të
14 kryqeve.

15 "Kemi thyerje të vertebrës së tretë që tregon që ky
16 fraksion ka ardhur për shkak të një objekti me energji të
17 lartë". Dhe ju keni shkruar në kllapa (ka kaluar një plumb).

18 "Lëndim në vertebrën e tretë lumbare që tregon lëndim
19 *perimortem* në pjesë të rëndësishme të trupit që shpjegon
20 shkakun e vdekjes."

21 Me ndihmën e një shënjuesi, ju lutem, shënoni në të majtë
22 të ekranit dhe shpjegoni pse keni menduar ju që ky lëndim në
23 vertebrën e tretë lumbare ka qenë shkaku i vdekjes, vertebra e
24 tretë e mesit?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Wyler

Faqe 27

1 ishte pyetje për ju.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Në pjesën e majtë të ekranit, kemi
3 modelin anatomik të trupit të njeriut ku kemi të dukshme
4 skeletin dhe sistemin vaskular. Vertebra L3 në këtë pjesë që
5 shpinës ka pesë vertebra. E para është më afër krahavorit, e
6 treta është këtu. Në këtë lartësi në pjesën e pjesës
7 abdominale ka një arterie, arterie abdominale, kjo e kuqja që
8 po shënoj unë, kjo është vena e arteries. Pra, vena është kjo
9 bluja. Plumbi apo objekti me shpejtësi shumë të lartë kinetike
10 ka përshkruar regjionin lumbar të trupit dhe ka dhënë një
11 goditje, i ka dhënë goditje aq të fortë sa ka dëmtuar organet
12 e brendshme. Plumbi në vertebrën e tretë me energji shumë të
13 lartë dëmton, mund ta dëmtojë aortën ose venën e zemrës dhe
14 shkakton hemorragji në pjesën abdominale.

15 PY. Dëshmitar, ju thatë që shënuar diçka dhe as shënimet s'më
16 kanë dalë, po ka ngrirë dhe transkripti. Dhe nuk e ndoqa dot
17 se çfarë thatë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fillimisht të
19 rregullojmë një herë transkriptin.

20 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e shoh që
21 është e reflektuar përgjigja. A mendoni që është e drejtë që
22 t'i bëjë dhe një herë pyetjen dëshmitarit?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Në rregull. E shikoj tani.

25 Megjithatë markimin e bërë ose shënimin e bërë në model nuk e

1 kemi nga dëshmitari.

2 PY. Kështu që do kërkoja dhe një herë, Dëshmitar, që të bëni
3 shënimin me marker tek modeli që keni në të majtë të ekranit
4 tuaj.

5 PË. Vertebra e tretë, ajo lumbare, që është pak a shumë në
6 këtë lartësi. Megjithatë me të kuqe, këtë shënim po e bëj
7 tani, këtu është pjesa abdominale e aortës. Dhe ngjitur me të
8 me ngjyrë blu është një venë.

9 Një plumb që ka shpejtësi të lartë dhe që përshkon
10 abdomenin shkakton dëmtim tek organet e kavitetit të pjesës
11 abdominale. Në këtë rast, plumbi ka kaluar shumë pranë
12 vertebrës së tretë lumbare ngjitur me pjesën abdominale të
13 aortës. Ky plumb me valë shoku që e shoqëron -- që e ka
14 shoqëruar, shkakton dëmtim në pjesën abdominale të aortës dhe
15 krijon gjithashtu dhe rrjedhjen e gjakut të pacientit.

16 PY. I nderuar Dëshmitar, faleminderit. Ishte shumë e qartë.

17 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Përderisa e kemi ngjyrën blu tek
18 modeli do të kërkoja që të ndryshonim pak ngjyrën e shënjesit
19 në mënyrë të tillë që t'i kemi të qartë shënimet që po bën
20 dëshmitari tani në sallën e gjyqit dhe do i kërkoja
21 Sekretarisë ndihmën për këtë.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A ta ruajmë këtë pjesë
23 tani? Sepse në qoftë se nuk e ruajmë, mendoj se do na humbin
24 shënimet e bëra nga dëshmitari.

25 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Jo, nuk është e nevojshme, mund ta

- 1 zmadhoni dhe mund të bëjmë një shënim të ri. Mund ta zmadhoni
2 edhe më tepër pamjen. Faleminderit. Kaq mjafton.
- 3 PY. Dëshmitar, a mund që të shënoni me një shigjetë vertebrën
4 e tretë lumbare?
- 5 PË. [Shënon]
- 6 PY. Ju lutem shënoni dhe kokën e shigjetës.
- 7 PË. [Shënon]
- 8 PY. Mendoj se më përpara ju bërë disa shënime të tjera plus
9 që kishin të bënin me pjesën e indeve të gjakut.
- 10 PË. Këtu me të kuqe janë enët e gjakut. Dhe siç mund ta
11 shikoni, bëhet ndarja në të majtë dhe në të djathtë.
- 12 ZNJ. WYLER: [Përkthim] A mund ta ruani këtë faqe, mund ta
13 ruani me ndryshimet që i bëri dhe me shënimet që i bëri
14 dëshmitari? E kam fjalën konkretisht për faqen 124937.
- 15 PY. Dëshmitar, ndërkohë që e ruajmë këtë pamje, juve po
16 përmendnit pak më përpara vertebrën L3. A është e vërtetë që
17 kujtohet pasqyron vertebrën L3 lumbare? L3, domethënë, është
18 shkurtimi për vertebrën e tretë lumbare?
- 19 PË. Po, është vertebra e tretë lumbare. Pra, numërimi i
20 vertebrave lumbare fillon nga fillimi, pra, nga ajo që është
21 më pranë krahavorit.
- 22 PY. Juve po flisnit konkretisht për vertebrën e tretë
23 lumbare, apo jo, Dëshmitar?
- 24 PË. Po. Vertebrën e tretë lumbare.
- 25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 [Përkthim] A dëshironi që t'i caktojme një numër provizor
2 këtij dokumenti, domethënë, e kam fjalën mbase me .1 të 2003 a
3 funksionon kjo për ju, Prokurore?

4 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Po. Megjithatë kur të vijë momenti
5 i përshtatshëm do kërkojmë pranimin në prova gjyqësore të
6 dokumenteve përkatëse, megjithatë për momentin do ishte mirë
7 që t'i caktojme një numër provizor prove.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë sugjeroj
9 që të përdoret 2003.1 për këtë dokument. Pra, do i caktohet
10 një numër provizor prove e kam fjalën konkretisht për pamjen
11 që sapo pamë që përfaqëson diagrami vaskular skeletor.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
13 i caktojme një numër dhe numri i Zyrës Administrative që do
14 caktojme për këtë dokument është REG001201.

15 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Duke pasur parasysh kohën dhe duke
16 qenë që është ora 10.10, nuk e di në qoftë se do bëjmë ndonjë
17 pushim.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

19 Dëshmitar, do bëjmë dhjetë minuta pushim. Mund të dilni
20 me Sekretaren e seancës nga salla.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 --- Seanca ndërpritet në orën 10.10

23 --- Seanca rifillon në orën 10.22

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
25 silleni dëshmitarin në sallë.

1 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të ngre
2 një çështje në qoftë se më lejoni përpara sesa ta sjellin
3 dëshmitarin në sallë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
5 mund të vazhdoni.

6 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Është thjesht një shpjegim që ka
7 të bëjë me një përgjigje ndaj një parashtimi të bërë nga ZPS-
8 ja lidhur me kohën, me vlerësimet e kohës për këtë dëshmitar.
9 Sigurisht, ne e dimë që ka një ndryshim shumë të madh për
10 kohën që kemi vlerësuar ne për të marrë në pyetje këtë
11 dëshmitar, megjithatë duam që të sqarojmë për procesverbal se
12 çfarë ka ndodhur.

13 Kur na është njoftuar -- pikësëpari ky dëshmitar,
14 Prokuroria ka propozuar për përdorim shumë dokumente, 197
15 dokumente dhe përveç dokumenteve të propozuara për përdorim,
16 bëheshe fjalë edhe për 75 dokumente të tjera shtesë, kështu që
17 ne, po, kemi marrë parasysh numrin e konsiderueshëm të
18 dokumenteve dhe kemi pasur gjithashtu edhe bazë prove rreth
19 200 dokumente, pjesa më e madhe e të cilëve është kundërshtuar
20 në përgjigje të rregullës 154.

21 Prokuroria u kundërpërgjigj që në fakt dokumentet do të
22 përdreshin me këtë dëshmitar, duke afirmuar këtë qëndrim.
23 Megjithatë kemi marrë një shënim përgatitor natën e së premtes
24 ku pas përfundimit të punës së zakonshme, orarit të zakonshëm,
25 domethënë, në orën 6.13 pasdite me një listë prej 65

1 dokumentesh, që ne nuk e dinim që Prokuroria në fakt do bënte
2 këtë shkurtim të konsiderueshëm të numrit të dokumenteve që
3 kishte përgatitur.

4 ZPS-ja nuk na ka njoftuar para së premtes dhe as na ka
5 njoftuar përmes mënyrave të tjera që do shkurtonin në mënyrë
6 kaq drastike dokumentet që do përdorte me këtë dëshmitar. Në
7 qoftë se do të kishim pasur njoftim në kohë nga Prokuroria për
8 zvogëlimin e numrit të dokumenteve, ne do të kishim pasur
9 mundësi që të bënim rregullimet përkatëse sa i takon kohës për
10 këtë dëshmitar, sepse po ta kishim ditur që mbi 250 dokumentet
11 do reduktoheshin në 65 përpara të premtes, do kishim bërë
12 rregullimet përkatëse.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit juve.

15 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për sa i takon
16 këtyre parashtimeve, besoj që do ishte mirë që të shikojmë
17 procesverbalin. Dhe më duket sikur ky është një keqinterpretim
18 i procesverbalit. Dua të them që Mbrojtja e Veselit ka
19 shkurtuar numrin e orëve nga pesë në tre më 8 janar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

21 Silleni dëshmitarin në sallë.

22 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
23 këshillohen]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet që të
25 korrigjojmë numrin e provës që ka të bëjë me diagramën që ka

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Wyler

Faqe 33

1 ardhur nga një burim tjetër. Pra, do i caktojmë një numër të
2 ndryshëm prove materiale të ndryshëm nga 2003.1 që e përmenda
3 pak më herët.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
5 nderuar Gjykatës. Do ta korrigjojmë numrin e provës nga ekran
6 që e kemi ruajtur më herët. Aktualisht do t'i caktojmë numrin
7 provizor P02004 në vend të P02003.1. Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
9 ju.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
12 Prokurore, mund të vazhdoni.

13 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
14 PY. Mirë se u kthyet, Dëshmitar. Tani do të kalojmë tek dy
15 viktima të tjera.

16 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretarisë
17 që të paraqesë në ekran faqen e raportit që përfundon me 34,
18 në fillim të faqes. Për viktimën e parë do i kërkoja
19 Sekretarisë që të paraqesë dokumentin me numër ERN
20 SPOE00072278. Është një dokument prej dy faqesh.

21 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj pjesë të raportit tuaj, do ju
22 tregoj gjithashtu edhe disa fotografi përpara sesa t'ju bëj
23 pyetjet e mia.

24 Në aktekspertizën tuaj, juve jepni këto përshkrime për
25 këtë fotografi. Është pika e parë e plumbit - jo, është e parë

1 që ju keni dhënë në raportin tuaj, ju thoni që:

2 "... aspekt anterior i vertebrës së tretë cervikale."

3 Thoni gjithashtu që:

4 "Ka gjithashtu edhe prerje të orientuara në mënyrë
5 tërthore."

6 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të vazhdojmë me faqen 3 të
7 raportit dhe nga ana tjetër e ekranit do i kërkoja Sekretarisë
8 që të paraqesë dokumentin me numër ERN SPOE00072262, përsëri
9 është një dokument prej një faqe.

10 PY. Në raportin tuaj ju jepni këtë përshkrim. Do lexojmë nga
11 pika e parë:

12 "... aspekti anterior i vertebrës cervikale numër 3 (tre)
13 prerje e mprehtë e orientuar."

14 Dhe thoni gjithashtu që:

15 "Incizionet në *corpus vertebrae* janë deri në disa
16 milimetra të thella."

17 A pajtoheni me mua se sipas këtij përshkrimi të dy
18 viktimat kanë pësuar të njëjtën lloj dëmtimi?

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Është sugjestionuese.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëni një
21 pyetje tjetër.

22 ZNJ. WYLER: [Përkthim]

23 PY. Dëshmitar, a pajtoheni se dy fotografitë tregojnë
24 incizione ose prerje shumë të ngjashme?

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Orientuese.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet t'i
2 thuash, duhet t'i bësh pyetje ndryshe, t'i thuash dëshmitarit
3 se çfarë tregon kjo pamje.

4 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Do doja të kërkoja që përveç
5 raportit të jepej një tjetër fotografi në ekran, më
6 konkretisht është fotografia që jepet në SPOE00072278.
7 Domethënë, në vend të raportit të jepni fotografinë tjetër.
8 PY. Dëshmitar, a mund të na thoni çfarë tregojnë këto dy
9 fotografi?

10 PË. Këto fotografi tregojnë vertebra cervikale. Te pjesa e
11 brendshme, jepet një traumë përmes një objekti të mprehtë, kjo
12 është pjesa anteriore e pjesës frontale të vertebrës.

13 PY. Domethënë, kjo është e vërtetë për të dyja fotografitë që
14 ju shikoni në ekran, i njëjti përshkrim zbatohet për të dyja,
15 apo jo?

16 PË. Po, kështu është. Përshkrimi që dhashë është i zbatueshëm
17 për të dyja autopsitë, për të dy pacientët.

18 PY. Në rregull. Faleminderit.

19 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që t'i
20 heqë të dy fotografitë dhe të shkojmë përsëri tek raporti i
21 ekspertit që ka numër provizor prove 02003, të shkojmë përsëri
22 tek faqja që përfundon me 37. Në anën tjetër të ekranit do
23 kërkoja që të paraqitet ilustrimi që kemi dhënë në seancë në
24 Shënimin Përgatitor numër 2 me ERN 124921 deri në 124937,
25 faqja e fundit. Përsëri është e nevojshme që dëshmitari të

1 bëjë shënimin përkatës.

2 PY. Ndoshta me ndihmën e mostrës ose pamjes që keni, a mund
3 të na thoni se kush është vertebra e tretë këtu, Dëshmitar? Ju
4 lutem na tregoni se cila është vertebra e tretë cervikale?

5 PË. Ne kemi shtatë vertebra. Vertebra e tretë, domethënë,
6 vertebra e tretë cervikale ose L3 është diçka që nuk e shohim
7 dot. Nuk e shohim në këtë fotografi. Është diku në këtë
8 lartësi pak a shumë.

9 PY. Faleminderit. Në cilën pjesë është vertebra, është në
10 pjesën e shpinës, të fytit apo në pjesën e parme?

11 PË. Trauma në këto vertebra gjendet në pjesën e pasme.

12 PY. Ndërkohë në raportin tuaj thuhet që kjo gjendet në
13 vertebrën e korpusit. Vertebra e korpusit ku gjendet në pjesën
14 e parme apo në pjesën e pasme?

15 PË. Korpusi është në pjesën e parme, pjesën përpara të
16 shpinës.

17 PY. Kur thoni në pjesën e parme e keni fjalën drejt fytit?

18 PË. Po. Kjo është një mënyrë për ta shprehur. A mund t'ju
19 tregoj vendin sepse po më pyesni lidhur me modelin që kam këtu

20 PY. Nuk mendojmë që është e nevojshme.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ju
22 dëgjova mirë. Thojeni dhe një herë?

23 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Nuk mendojmë që është e nevojshme.

24 PY. Një lëndim i tillë që e përshkruani ju në raportin tuaj,
25 a krijon apo shkakton dëmtim të organeve?

1 PË. Në rregull. Sa i takon një instrumenti të mprehtë, kur
2 një instrument i mprehtë krijon një prerje, pra, për të
3 krijuar një prerje në vertebrën numër 3 duhet që të kalojë nga
4 indet e buta një herë dhe të kalojë gjithashtu në organe të
5 ndryshme si, për shembull, në ezofag, po ashtu në kemi edhe
6 enët e gjakut në të majtë dhe në të djathtë. E kemi të shënuar
7 këtu me ngjyrë të kuqe. Dhe kemi gjithashtu edhe venat e
8 gjakut me ngjyrë blu. Kështu që, ky instrumenti i mprehtë
9 përpara sesa të futet në vertebër duhet që të presë këto indet
10 e buta dhe pjesët ose venat e gjakut që janë në këtë lartësi,
11 pra, duhet që të kalojë nga faringu, nga e tjerë.

12 PY. Tani, me markuesin që keni a mund të na shënoni tek
13 fotografia që keni përpara se cilët enë gjaku duhet që të
14 priten në mënyrë të tillë që të ceket vertebra e tretë.

15 PË. Kjo është arteria e djathtë pastaj e majtë. Pra, këto
16 janë arteriet cervikale dhe venat.

17 PY. Dëshmitar, meqenëse kemi tre shënime në këtë ilustrim, a
18 mund të shtoni një përshkrim në pjesët ku keni bërë shënime
19 duke shkruar me stilolaps në pjesën e ilustruar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

21 Prokurore, kjo nuk do të jetë shumë e qartë. Ai po përdor, po
22 bën një rresht mbi të dhe pastaj shkruaj diçka tjetër. Duhet
23 të jeni më e qartë në mënyrën sesi doni që ai ta bëjë këtë
24 gjë.

25 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Do ta bëj këtë gjë.

1 PY. Pra, në qoftë se mund të fillojmë me vertebrën cervikale
2 të tretë, të cilën ju e keni shënuar dhe shënoheni atë me një
3 vizë që shkon deri jashtë shtyllës kurrizore, boshtit
4 kurrizor. A mundeni ju lutem? Në fund të kësaj vije të shënoni
5 fjalët "Vertebra e tretë cervikale" me shkrim. E kuptuat çka ju
6 kërkova?

7 PË. A po më kërkoni lidhur me këtë prerjen në nivelin aty ku
8 është vertebra e tretë cervikale.

9 PY. Po i referohem kësaj, por së pari do të doja që të
10 përfundojmë me shënimet mbi ilustrimin. Aty ku keni vizën që
11 shkon në drejtim të vertebrës së tretë cervikale, a mund të
12 shtoni aty numrin 1 në atë rresht, në atë vizë?

13 PË. [Shënon]

14 PY. Dhe konfirmoni ju lutem që të dy vizat që shkojnë poshtë
15 janë shënimet e tua për arteriet dhe venat, a është kështu?

16 PË. Ajo që kemi këtu me ngjyrë jeshile janë arteriet dhe
17 venat të cilat çojnë gjakun në kokë.

18 PY. Dhe këto janë dy rreshtat, vizat që shkojnë nga koka në
19 drejtim poshtë, apo jo?

20 PË. Këto dy vija vertikale që janë në ngjyrë të jeshile
21 tregojnë arteriet të cilat çojnë gjakun nga zemra në kokë. Dhe
22 në ngjyrë blu, të kaltër kemi venat.

23 PY. Faleminderit. Bazuar në informacionin që ishte në
24 dispozicionin tuaj, a mund të përshkruani çfarë mund të ketë
25 shkaktuar një lëndim të tillë?

1 PË. Këto lëndime janë shkaktuar me një mjet të mprehtë. Nga
2 informacioni që ne kemi marrë, arkeologu në atë vend ku janë,
3 në vendin ku janë zbuluar, gjetur pacientët, një kosë është
4 gjetur aty.

5 PY. Lëndimet e konstatuara a mund të jenë shkaktuar nga kosa?

6 PË. Plagët e gjetura, pra, të konstatuara gjatë autopsisë
7 janë --

8 PY. Bazuar në informacionin në dispozicion tuaj, sipas
9 përvojës tuaj, këto lëndime a mund të jenë shkaktuar nga një
10 person?

11 PË. Ndoshta. Me qëllim që kosa të presë vertebrën e tretë
12 cervikale që ta presë këtë duhet që ajo të tërhiqet mbrapsht,
13 pra, duke u kthyer. Pra, me shumë gjasa këtë veprim duhet ta
14 kenë bërë më shumë se një person pra.

15 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

16 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Në qoftë se mund t'i ruajmë
17 shënimet e bëra në ekran dhe ti japim një numër provizor.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.
19 Shënimet e bëra nga dëshmitari do të marrin numrin e provës
20 provizore P022005. Do të regjistrohen në *Legal Workflow* sipas
21 numrit të regjistrimit REG01202. Klasifikimi është konfidencial.
22 Faleminderit.

23 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

24 PY. Dëshmitar, do të kalojmë në një çështje tjetër.

25 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Do t'i kërkoja Sekretares së

- 1 Gjykatës që t'i heqë të dy dokumentet.
- 2 PY. A e njihni, Dëshmitar, Maria Francmann?
- 3 PË. A mund ta përsërisni pyetjen?
- 4 PY. A e njihni Maria Francmann?
- 5 PË. Profesoresha Maria Francmann nga Danimarka.
- 6 PY. Personi që ju kujtoni, si e njihni atë?
- 7 PË. Ajo është profesore e mjekësisë ligjore, e cila për një
- 8 kohë të caktuar ka punuar në Kosovë dhe ka bërë autopsi atje.
- 9 PY. A keni marrë pjesë në autopsitë e bëra nga ajo
- 10 ndonjëherë? A keni qenë i pranishëm?
- 11 PË. Në kohën kur punoja për Qendrën për Ndihmë Ndërkombëtare
- 12 të Mjekësisë Ligjore, zakonisht kam qenë i pranishëm gjatë
- 13 gjithë autopsive. Natyrisht, mund të ketë -- ka ndodhur që nuk
- 14 kam qenë i pranishëm gjatë një apo një tjetër autopsie, por
- 15 kam qenë i pranishëm gjatë pjesës më të madhe të autopsive.
- 16 Kam përpunuar për organizatën, për këtë organizatë për tre
- 17 muaj dhe ka patur doktorë të tjerë, patologë të tjerë që kanë
- 18 ardhur për një periudhë më të shkurtër kohore.
- 19 PY. Cila ishte periudha kohore e punës e Maria Francmann?
- 20 PË. Nuk e di. Më kujtohet që ka punuar për një periudhë të
- 21 caktuar kohore.
- 22 PY. Mund të jetë çështje përkthimi ndoshta, por mendoj që
- 23 përmendët në përgjithësi autopsitë dhe autopsitë e bëra. A e
- 24 kishit fjalën për autopsitë e bëra nga Maria Francmann apo në
- 25 përgjithësi?

1 PË. Po flisja në përgjithësi për të gjitha autopsitë.

2 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në
3 ekran dokumentin SITF00175086 deri në SITF00175147 dhe në
4 faqen që përfundon me 96. Po, kjo është. Mund të zmadhojmë
5 pjesën e sipërme të faqes.

6 PY. Në krye të këtij raporti të autopsisë shohim datën që
7 është 14 maj 2002. Inicialet afër fjalës patolog janë MBF.

8 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Tani kalojmë tek faqja 104. Në
9 fund të faqes. Faleminderit.

10 PY. Kjo është faqja e fundit e këtij raporti të autopsisë.
11 Edhe këtu mban emrin që është Maria B Francmann dhe data 14
12 maj 2002. A pajtoheni me mua që ky është raporti i një
13 autopsie të bërë nga znj. Francmann?

14 PË. Po, pajtohem me deklaratën.

15 PY. Të shohim tani raportin e autopsisë pak më nga afër për
16 që të flasim për përfshirjen tuaj në këtë autopsi.

17 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Do të kërkoja të shfaqim faqen 99,
18 që përfundon me shifrat 99. Kalojmë tek pjesa në fund.

19 PY. Këtu në titull kemi "Lëndimet kryesore të përshkruara",
20 "Koka, qafa":

21 "Kafka: Është bërë një ndërprerje, thyerje e pjesës
22 zigomatike përballë, të pjesës së ballit me një çngjyrosje në
23 të kuqe për indet e buta dhe kockat."

24 Ku në pjesën -- në cilën pjesë të kokës dhe qafës është
25 zigomatikotemporal?

1 PË. Në përgjithësi është mes hundës dhe syrit dhe gojës. Mund
2 të shkojë deri tek veshi i majtë. Po flasim për këtë pjesë të
3 fytyrës.

4 PY. E ça do të thotë hapje e qepjes apo?

5 PË. Kjo do të thotë që pika e bashkimit, pra, pika e lidhjes
6 është thyer.

7 PY. Cili mund të jetë shkaku i një lëndimi të tillë?

8 PË. Këto plagë zakonisht shkaktohen nga një send i fortë,
9 mjet i fortë në rastet kur ai përdoret me një forcë të
10 caktuar.

11 PY. Çngjyrosje e skuqur e indeve të buta edhe e kockës -- e
12 indeve të buta të kockave ku shihet një gjë e tillë?

13 PË. Në fjalinë e parë të autopsisë, Maria shkruan "kufoma e
14 ruajtur mirë", që do të thotë që pacienti, trupi i pacientit
15 ishte në gjendje të mirë, të ruajtur mirë. Prania e ndryshimit
16 të kësaj ngjyre me shumë gjasa është shkaktuar na gjakderdhja
17 vaskulare në atë zonë të trupit, në atë pjesë të trupit.

18 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë tani në faqen
19 që përfundon me 100. Faleminderit.

20 PY. Në këtë nëntitull shohim "Trupin":

21 "Brinjët:

22 "Pjesa e djathtë: Brinja numër 6, 7 janë thyer në pjesën
23 e jashtme. Çngjyrosje e kuqe, e ngjyrës së kuqe në brinjë dhe
24 në indet e buta. Lëng ngjyrë e kuqe në zgavrën e gjoksit në
25 pjesën e djathtë.

1 "Pjesa e majtë: Brinja 5-9 të thyera në pjesën e jashtme.
2 Brinja 8-10 të thyera në pjesën anash dhe numër 9 kemi dy
3 thyerje të anshme, pra, laterale. Kemi çngjyrosje të kuqe të
4 kockave dhe indeve të buta."

5 Përveç çngjyrosjes së kockave dhe të indeve të buta
6 lexojmë edhe një lëng të ngjyrës së kuqe në pjesën e djathtë
7 të zgavrës së gjoksit në këtë paragraf. A mund të na thoni nga
8 ky përshkrim çfarë lloj lëngu trupor është ky?

9 PË. Ajo që përshkruhet këtu, kemi brinjë të thyera 6,7 në
10 anën e djathtë dhe në anën e majtë brinjët 5 deri në 9 dhe 8
11 deri në 10. Që do të thotë, thyerje të brinjëve në të dy anët.
12 Në pjesën mes dy brinjëve kemi një arterie dhe një venë,
13 arteria *vertebralis* dhe vena *vertebralis*. Brinjët e thyera të
14 cilat dëmtojnë indet e buta, do të thotë, që këto vena dhe
15 arterie kanë plasur dhe kanë shkaktuar gjakderdhje në zgavrën
16 e gjoksit. Pra, dëmtimet, lëndime të mëdha, brinjë të thyera
17 shkaktojnë edhe dëmtime në mushkëri, në indet e mushkërive dhe
18 këto janë dy burimet të gjakderdhjes që ne kemi vërejtur në
19 rastin e pacientit i cili kishte shumë brinjë të thyera,
20 kishte gjithashtu një therje, shpim të mushkërive.

21 PY. Bazuar në një formacion që keni marrë në këtë raport të
22 autopsisë nëse personi do t'i ishte dhënë -- që ka pasur, ka
23 pësuar këto plagë, në qoftë se personi që ka pësuar këto plagë
24 nuk do të merrte trajtim mjekësor a do të mbijetonte?

25 PË. Është pyetje shumë e mirë. Me lëndime, plagë kaq të mëdha

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Wyler

Faqe 44

1 nuk ka gjasa dhe ndoshta edhe me ndihmë mjekësore të duhur në
2 kohë të duhur, pra, nuk do të kishte gjasa që personi të
3 mbijetonte, të shpëtonte. Ka shumë -- është e pagjasë.

4 PËRKTHYESI: I kërkojmë dëshmitarit të flasë më afër
5 mikrofonit.

6 ZNJ. WYLER: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që keni dhënë dëshmi si
8 dëshmitar ekspert në një seancë gjyqësore përpara gjykatësës
9 Agnieszka Klonowiecka-Milart në tetor të 2002?

10 PË. Në vitin 2002, kur po punoja në Kosovë në atë çështje kam
11 dhënë nj deklaratë shtesë përpara një gjykatësi ndërkombëtar.

12 PY. A ju kujtohet kjo seancë, kjo seancë konkrete për të
13 cilën po flas para gjykatësës Agnieszka Klonowiecka-Milart?

14 PË. Jo, nuk më kujtohet.

15 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Atëherë të shfaqim në ekran
16 dokumentin SPOE00123936 deri në 00123940 RED.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Do të kërkoja të na sqarojë
18 Prokuroria nëse ky dokument po përdoret për të freskuar
19 kujtesën e dëshmitarit sepse mënyra, arsyeja për të cilën ky
20 dokument pranohet ka pastaj implikime dhe pasoja ndikim në
21 pranueshmërinë e tij, apo jo, të mëvonshme.

22 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Do të lexoj thjesht një paragraf
23 të shkurtër dëshmitarit për të sqaruar përfshirjen e tij në
24 raportin e autopsisë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Vazhdoni.

2 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Kalojmë në faqen 37 në mes të
3 paragrafit.

4 PY. Dhe do të lexoj pjesën e këtij paragrafi që fillon me:

5 "Nuk ka thyerje në kafkë". "Më lejoni t'ju tregoj në
6 fytyrën time ku gjendet pjesa e bashkimit, pra, lidhja
7 zigomatikotemporale (dëshmitari tregon pjesën e sipërme të
8 kockës së faqes dhe trekëndëshin mes veshit dhe syrit) ka
9 shumë gjasa që këto lëndime të jenë shkaktuar nga një goditje
10 me send të fortë. Lëndimi tjetër gjendet në pjesën e gjoksit
11 në anën e djathtë dhe të majtë të gjoksit. Në anën e djathtë
12 të gjoksit kemi brinjët e thyera 6, 7 në pjesën e jashtme me
13 çngjyrosje të kuqe të indeve të buta rreth tij. Gjatë
14 autopsisë kemi gjetur edhe lëngun e kuq në pjesën e djathtë të
15 zgavrës së gjoksit. Mund të arrijmë në përfundimin se më shumë
16 gjasa, ka qenë gjakderdhje e brendshme në pjesën e djathtë të
17 zgavrës së gjoksit. Gjithashtu kemi një lëndim në anë e majtë
18 në brinjën 5 deri në 9 që gjendet në pjesën e jashtme të
19 gjoksit dhe brinjët 8, 9, 10 në pjesën e jashtme të majtë dhe
20 brinja 9 në pjesën e pasme të jashtme. Brinja 9 është thyer
21 tre herë, brinja 8 është thyer dy herë dhe ka patur në anën e
22 majtë të zgavrës së gjoksit një çngjyrosje të kuqe të kockave
23 dhe të indeve të buta. Mund të arrijmë në përfundimin se me
24 shumë gjasa ka qenë goditje nga një send i fortë në fytyrë dhe
25 goditje e shumëfishtë me sende të forta në pjesën e gjoksit,

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Wyler

Faqe 46

1 kemi ekzaminuar edhe kockat e krahëve dhe këmbëve dhe nuk ka
2 patur fraktura nuk kemi gjetur çngjyrosje të qartë, të dukshme
3 por ka qenë pjesërisht e dekompozuar."

4 Duke parë këto lëndime të përshkruara në këtë paragraf në
5 raportin e autopsisë që sapo e diskutuam, a pajtoheni që ato
6 kanë përshkruar të njëjtën viktimë?

7 PË. Këto lëndime përshkruajnë të njëjtën viktimë, të njëjtin
8 pacient.

9 PY. Dhe sipas -- dhe në përputhje me seancën e tetorit 2002,
10 ju dëshmuat si dëshmitar ekspert lidhur me raportin e
11 autopsisë që sapo diskutuam i cili ishte i datës, i bërë në
12 maj 2002?

13 PË. Po, kam dhënë dëshmi lidhur me këtë çështje.

14 PY. Dhe ku përqendrohemi në fjalitë "Gjatë autopsisë kemi
15 gjetur ...", gjithashtu "Mund të arrijmë në përfundimin ..."
16 dhe kështu me radhë, a e kuptoj mirë që ju keni dhënë dëshmi
17 në këtë seancë gjyqësore, kur keni dhënë dëshmi në këtë seancë
18 gjyqësore ju po i referoheshit autopsisë që, në fakt, në cilën
19 ju keni marrë pjesë.

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Pyetje suggestionuese.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

22 Vazhdoni.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Kam qenë i pranishëm gjatë
24 autopsisë por nuk më kujtohet kjo. Kjo ka ndodhur para 23
25 vitesh.

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Wyler

Faqe 47

1 ZNJ. WYLER: [Përkthim]

2 PY. Faleminderit.

3 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Shoh kohën, të nderuar Gjykatës.

4 Është ora 11.00.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 Dëshmitar, do të marrim një gjysmë ore pushim. Mund të
7 largoheni nga salla e gjyqit me punonjësen e gjykatës.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
10 ndërpritet deri në orën 11.30.

11 --- Seanca ndërpritet në orën 11.02

12 --- Seanca rifillon në orën 11.34

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
14 sillni dëshmitari në sallë.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do vazhdojmë
17 me pyetjet e Prokurorisë, z. Dëshmitar.

18 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

19 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

20 PY. Flasim për një temë tjetër.

21 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ju lutem, vendosni në ekran
22 materialin që mban numrin ERN 031049-031095, tek faqja që
23 përfundon me 52. Faleminderit.

24 PY. Dëshmitar, a është nënshkrimi juaj ky në faqe?

25 PË. Po, është nënshkrimi im.

1 PY. A e keni përgatitur ju këtë raport?

2 PË. Po, unë e kam përgatitur.

3 PY. A e keni kryer ju autopsinë që përshkruhet në këtë
4 raport?

5 PË. Po, unë personalisht e kam bërë autopsinë që përshkruhet
6 në këtë raport.

7 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Shkojmë në faqen që përfundon me
8 51.

9 PY. Në pjesën e sipërme të kësaj faqeje, tek titulli që thotë
10 "Përshkrimet për lëndimet kryesore *ante-mortem*", ju keni
11 thënë:

12 "Plagë zjarri që kanë hyrë në femurin e djathtë dhe kanë
13 shkatërruar patelën e djathtë, armë", -- më falni, "e shtënë
14 me armë zjarri që ka dëmtuar po ashtu pjesën e djathtë të
15 fyellit të këmbës."

16 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Shkojmë në faqen që përfundon me
17 52.

18 PY. Ju keni thënë këtu:

19 "Shkaku i vdekjes është e shtëna me armë zjarri në këmbën
20 e djathtë."

21 Dëshmitar, a mund të na përshkruani se si e ka shkaktuar
22 vdekjen e këtij personi e shtëna me armë zjarri që përshkruat
23 në raportin tuaj?

24 PË. Plagët e zjarrit kanë qenë tek gjuri i djathtë, në këmbën
25 e djathtë. Pjesa, zona e gjurit të djathtë është një pjesë që

1 kalon në arterie, edhe venat arteriale. Edhe dëmi ka qenë kaq
2 i madh i kockës, saqë ka shkaktuar -- në fakt kanë qenë disa
3 të shtëna me armë zjarri, në këmbën e djathtë, në gjurin e
4 djathtë, dhe këto të shtëna kanë hyrë në enët e gjakut dhe
5 enët e gjakut janë dëmtuar. Dëmtimi i enëve të gjakut ka
6 shkaktuar gjakderdhjen dhe vdekjen e pacientit.

7 PY. Sipas jush, si ekspert, çfarë ndodh nëse nuk trajtohet
8 një plagë e tillë?

9 PË. Pacienti vdes për shkak të hemorragjisë.

10 PY. Tani do të flasim për një viktimë tjetër.

11 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Do lutesha të vendosej në ekran
12 dokumenti që mban numrin ERN SITF0019793, 0019810 RED, në
13 faqen 95. Ju lutem, të shkojmë në fund të faqes.

14 PY. Dëshmitar, a është nënshkrimi juaj ky?

15 PË. Po, nënshkrimi im është?

16 PY. A e keni përgatitur ju këtë raport?

17 PË. Po, unë e kam përgatitur.

18 PY. A e keni kryer ekzaminimin që përshkruhet në raport?

19 PË. Po, unë e kam kryer ekzaminimin e këtij pacienti.

20 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Shkojnë në faqen që -- jo, më
21 lart.

22 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj dy paragrafë të këtij raporti
23 dhe më pas do t'ju tregoj disa fotografi, dhe më pas të bëj
24 pyetje. Po lexoj dy pikat e para që thuhet kështu:

25 "Në pjesën e epërme, të lartë, të krahavorit, ka shenjë

1 sipërfaqësore të parregullta të shpërndara në një sipërfaqe që
2 është 9 me 8 centimetra", është fotografia 07 dhe 08. "Në
3 llambë ultraviolet, ka disa shenja të shpërndara të pakta që
4 janë pak a shumë të rrumbullakëta, në formë të rrumbullakët".

5 "Në pjesën e sipërme, posteriore të shpatullës së
6 djathtë, ka shenja sipërfaqësore të parregullta e të
7 shpërndara në një sipërfaqe që janë të një madhësie rreth 7-6
8 centimetra", fotografia 18, 19.

9 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ju lutem, tani të shikojmë faqen
10 që përfundon me numër 98. Shikojmë poshtë në faqen tjetër. Dhe
11 tani shikojmë tek faqja që përfundon me 802. Faleminderit.
12 PY. Fotografitë që sapo pamë, a shfaqin, a tregojnë shenjat
13 në kraharor dhe në shpatull që janë përshkruar në atë pjesë të
14 raportit që lexova unë?

15 PË. Shenjat e përshkruara në raport janë shenjat që janë të
16 dukshme, në fotografi. Të paktën në fotografitë që pashë unë.

17 PY. Në raportin tuaj ju e përcaktuat dot shkaku e këtyre
18 lëndimeve, cila qe natyra e këtyre lëndimeve?

19 PË. Këto shenja, vrama, janë si pasojë e një lëndimi. Nëse më
20 kujtohet saktë, pacienti ka thënë se është, i ka pësuar këto
21 lëndime, e kishin djegur me cigare, domethënë janë, mbase këto
22 shenja janë për shkak të këtij lloji lëndimi, të kësaj natyre.

23 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin dhe të
24 vendosim dokumentin që mban numrin ERN SITF00019134, deri në
25 SITF00019150 RED, dhe të shohim faqen që përfundon me 38.

1 PY. Flasim për një viktimë tjetër tani, Dëshmitar.

2 ZNJ. WYLER: [Përkthim] -- poshtë ju lutem, në faqe.

3 PY. A është nënshkrimi juaj?

4 PË. Po, është nënshkrimi im.

5 PY. Ju e keni përgatitur këtë raport?

6 PË. Po, unë e kam përgatitur.

7 PY. A e keni përshkruar, e keni kryer ju ekzaminimin që
8 përshkruhet në këtë raport?

9 PË. Po, unë personalisht e kam kryer ekzaminimin e pacientit.

10 PY. Në këtë faqe shohim emrin e viktimës që nuk do ta lexojmë
11 në fakt, se jemi në seancë publike. Dhe në fund të raportit ju
12 keni bërë, i keni dhënë një "Rekomandim":

13 "Personi i ekzaminuar duhet të shkojë tek një mjek klinik
14 dhe duhet të kryejë ekzaminim, duhet të kryejë eko",
15 domethënë, "të kokës dhe të këmbës së majtë."

16 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Përbri këtij raporti, ju lutem, të
17 vendosim dokumentin që mban numrin ERN SITF00372709, 00372732,
18 dhe të shohim faqen që përfundon me 21 në ekran. Në pjesën e
19 dytë të faqes, ju lutem.

20 PY. Dëshmitar, poshtë titullit të raportit i ekzaminimit
21 fizik, thuhet:

22 "Ndryshim:

23 "i raportit ekzaminues OMPF", është dhe numri i
24 protokollit.

25 E kuptoj unë drejt që ky është një raport në vijim të

1 raportit që pamë, që shikojmë në të djathtë të ekranit?

2 PË. Po, është raport shtesë.

3 PY. Që ta sqarojmë, raporti në të majtë të ekranit a është i
4 juaji? Pra, a është nënshkrimi juaj në faqe?

5 PË. Në të majtë --

6 PY. Po.

7 PË. -- po, nënshkrimi im është në raport.

8 PY. E keni përgatitur ju?

9 PË. Po, unë e kam përgatitur.

10 PY. Tani do të shohim disa raporte autopsish dhe certifikata
11 vdekjesh. Lidhen me viktima të ndryshme. Do ju lutesha,
12 thjesht të na thoni nëse jeni ju autori i materialeve që do të
13 shohim.

14 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ju lutem, të vendoset në ekran
15 dokumenti që mban numrin ERN IT-03-66 ose përndryshe prova
16 P228. Shikojmë në fund të faqes, të shohim nënshkrimin. Të
17 kalojmë dhe në faqen tjetër. Në mes të faqes.

18 PY. Dy nënshkrimet që sapo patë, Dëshmitar, a janë
19 nënshkrimet tua?

20 PË. Po, të miat janë.

21 PY. A e keni përgatitur ju këtë certifikatë?

22 PË. Po, unë e kam përgatitur këtë dokument për të konfirmuar
23 vdekjen e personit në fjalë.

24 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Shohim dokumentin e radhës që
25 është me numër ERN SITF00030155 deri në SITF000 -- 00030184

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Wyler

Faqe 53

1 RED2 dhe shohim faqen që përfundon me numrin 81.

2 PY. Dëshmitar, ju lutem, shihni këtë nënshkrim dhe do të
3 shohim dhe nënshkrimin në faqen tjetër, tek faqja 82. Këto dy
4 nënshkrime, a janë nënshkrimet tua?

5 PË. Po, nënshkrimet e mia janë.

6 PY. A e keni përgatitur ju këtë certifikatë?

7 PË. Po, unë e kam përgatitur.

8 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dokumenti i radhës që do të doja
9 të shihnim është dokumenti që mban numrin SITF000181171 [Sipas
10 përkthimit] në faqen e parë -- më falni, 0018171 [Sipas
11 përkthimit] deri në 0018185 [Sipas përkthimit], faqja e parë.
12 Të shohim nënshkrimet sërish.

13 PY. Ju lutem, Dëshmitar, shihni këtë nënshkrim, shohim dhe
14 nënshkrimin në faqen tjetër.

15 PË. Po, nënshkrimet e mia janë. Nënshkrimi im është.

16 PY. Në të dyja faqet?

17 PË. Në të dyja faqet janë nënshkrimet e mia.

18 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Shkojmë tek faqja që përfundon me
19 85.

20 PY. A është dhe ky nënshkrimi juaj?

21 PË. Po, është nënshkrimi im.

22 PY. A është shkrimi juaj?

23 PË. Po, është shkrimi im.

24 PY. A jeni ju personi që keni përgatitur certifikatën ku pamë
25 nënshkrimet tua dhe raportin që kemi tani përpara?

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Wyler

Faqe 54

1 PË. Kam përgatitur raportin ndërsa certifikatat e vdekjes i
2 kam përgatitur në bazë të raportit të autopsisë.

3 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Vendosim tani në ekran materialin
4 që mban numër SPOE00325698 deri në 00325769, dhe shohim faqen
5 që përfundon me 706.

6 Të nderuar Gjykatës, ky është një material që, për të
7 cilin kemi kërkuar të shtohet në listën tonë të materialeve,
8 dhe për të cilin nuk është marrë ende asnjë vendim.

9 Faqja që përfundon me 706.

10 PY. E njëjta gjë, Dëshmitar. Do t'ju tregoj faqet dhe të më
11 konfirmoni nënshkrimin tuaj. Pra, në këtë faqe, ky nënshkrim
12 është një raport.

13 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Shohim më lart.

14 PY. Për lëndën -- për çështjen, më falni, FKT20/167BP, shkak
15 i vdekjes, i papërcaktuar. Shohim tani dhe faqen tjetër që
16 përfundon me 711, është faqja e fundit e raportit tuaj me
17 shkrim dore, për të njëjtën çështje. Pra, a janë këto dy
18 nënshkrimet tuaja?

19 PË. Po, janë nënshkrimet e mia dhe është shkrimi im.

20 PY. Në rregull.

21 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Shkojmë në faqen që përfundon 714.

22 PY. Është raporti që është bërë për rastin, për çështjen
23 FTK20/112BP. Edhe këtu shkak i vdekjes i papërcaktuar.
24 Nënshkrimi këtu, shohim dhe nënshkrimin në faqen tjetër që
25 përfundon me 19. Në fund. Kjo është faqja e fundit e raportit

1 tuaj me shkrim dore. Njësoj si dhe më përpara, do t'ju bëj të
2 njëjtën pyetje. A janë këto nënshkrimet tuaja?

3 PË. Po, janë nënshkrimet e mia dhe ky është shkrimi im i
4 dorës.

5 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ju lutem, tani shkojmë në faqen që
6 përfundon me 737.

7 PY. Edhe ky është një raport i një autopsie, i shkruar me
8 shkrim dore, që është për rastin FKT20/035BP, edhe këtu shkaku
9 i vdekjes i papërcaktuar. A është nënshkrimi juaj në fund të
10 faqes?

11 PË. Po, është i imi.

12 PY. Po në faqen që përfundon me 49, që është faqja e fundit
13 për të njëjtën çështje, a është nënshkrimi juaj?

14 PË. Po është nënshkrimi im edhe shkrimi -- edhe nënshkrimi
15 edhe shkrimi im.

16 PY. Faqet e fundit që më nevojiten përfundojnë me 755. Është
17 raport me shkrim dore për çështjen FKT20/046BP, shkaku i
18 vdekjes i papërcaktuar. Dhe faqja tjetër përfundon me 62, që
19 është faqja e fundit e raportit tuaj fillestar. Pyetja ime
20 është, a është ky nënshkrimi juaj?

21 PË. Po, është nënshkrimi im edhe shkrimi im.

22 PY. A jeni ju personi që i ka përgatitur këto katër raporte?

23 PË. Po, unë i kam përgatitur.

24 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dokumenti i fundit që do të shohim
25 për momentin. Atëherë, ju lutem të vendoset në ekran dokumenti

1 që mban numër ERN SPOE00194606 deri në 00194608, dhe të shohim
2 faqen që përfundon me 07. Qëndrojmë këtu, e zmadhojmë.

3 PY. Në këtë raport mund të shihni numrin. Është çështja
4 FKT20/172BP. E njëjti kod si raportet e tjera. A ju kujtohet
5 për cilën vendndodhje, cilës vendndodhje i përkonte ky kod?

6 PË. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet për cilin vend ishte ky
7 kod.

8 PY. Ne kemi informacion që ky është kodi që është përdorur
9 për zhvarrimet në kodin -- më falni, në shpellën e Voljakut, a
10 ju ndihmon kjo?

11 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] I lutem Prokurores të mos e japë
12 vetë informacionin, të mos nxjerrë dëshmi.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është
14 mënyra më e përshtatshme kjo për të rifreskuar kujtesën.
15 Pranohet kundërshtimi.

16 ZNJ. WYLER: [Përkthim]

17 PY. A ju kujtohet kjo autopsi?

18 PË. Nuk më kujtohet. Kjo autopsi është bërë në dhjetor të
19 2004, ka 20 vjet.

20 PY. Keni punuar ju, keni pasur ndonjë rast me kufoma që janë
21 nxjerrë nga shpella e Voljakut?

22 PË. Nuk më kujtohet konkretisht për cilin, nuk e di cilët
23 pacientë kanë qenë mbetjet, nuk e di cilat mbetje janë nxjerrë
24 nga arkeologët në këtë shpellë dhe se ku konkretisht. Nuk më
25 kujtohet.

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Wyler

Faqe 57

1 PY. Ka kaluar shumë kohë që prej atëherë. Ju keni kryer
2 qindra autopsi gjatë karrierës suaj, Dëshmitar, apo jo?
3 PË. Ju lutem, a e përsërisni dhe një herë pyetjen, e shprehni
4 pak ndryshe për ta kuptuar?

5 PY. Po. A keni kryer ju qindra autopsi gjatë karrierës tuaj?

6 PË. Gjatë punës që kam kryer në vendin tim, në Poloni, unë
7 kam bërë shumë autopsi të personave që kanë vdekur përpara
8 kohës, por gjithashtu edhe autopsi antropologjike. Megjithatë,
9 nuk mund t'ju them dot se sa në numër. Pa diskutim që kanë
10 qenë shumë, por numrin nuk e përcaktoj dot. Sa i takon
11 misionëve, pra në nivel ndërkombëtar gjatë 12 viteve unë
12 gjithashtu kam kryer shumë autopsi, por asnjëherë nuk i kam
13 numëruar ekzaktësisht se sa janë këto autopsi.

14 PY. A mund të jetë kjo një prej arsyeve se pse nuk ju
15 kujtohet kjo autopsi?

16 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Është sugjestionuese, i nderuar
17 Gjykatës.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

19 ZNJ. WYLER: [Përkthim]

20 PY. A është e saktë që data e këtij raporti autopsie është 25
21 janar, sikurse mund ta shikoni në fund të faqes, por në fakt
22 autopsia është shkruar me 8 dhjetor 2004. A është kështu?

23 PË. Sipër, në të majtë të faqes, ju keni datën 8 dhjetor
24 2004. Zakonisht këto, këtu janë datat në të cilat ne kemi
25 kryer autopsitë. Megjithatë, në fund keni emrin tim, nuk ka

1 një nënshkrim dhe aty data është 25 janar 2005.

2 PY. Sipas jetëshkrimit tuaj, ju keni punuar në Kosovë gjatë
3 të dyja viteve, domethënë në 2004 dhe 2005. A është e saktë
4 kjo, Dëshmitar?

5 PË. Në atë kohë unë kam punuar për Misionin e Kombeve të
6 Bashkuara në Kosovë.

7 PY. Faleminderit. Pyetja ime e fundit për ju, Dëshmitar, për
8 momentin është kjo: A mund të na shpjegoni termin "Lëndim në
9 trajtën e vrimës së çelësit të derës"?

10 PË. Normalisht, tipikisht, ky është një term i cili përdoret
11 për të përshkruar lëndime përmes armës së zjarrit në eshtrat e
12 kokës, në këndin 90 gradë, dhe kjo vrimë ka formën rrethore
13 dhe ka gjithashtu edhe një përthyerje në brendësi që po ashtu
14 në formë rrethore. Megjithatë, në qoftë se plumbi futet në
15 skalpin e kokës në një kënd të caktuar, sikurse mund ta dini,
16 pjesa e qafës ka një gjerësi të caktuar, kështu që ne kemi
17 shtresa të ndryshme. Pra, në një kënd të caktuar, pjesa e
18 brendshme -- pjesa e jashtme bie dhe për këtë arsye krijohet
19 një lloj zgjerimi që ne e quajmë si krater, dhe ajo ndjek
20 drejtimin e hyrjes së plumbit. Për këtë arsye, ne kemi ose
21 përftojmë një lëndim që merr formën e vrimës ku futet çelësi i
22 derës. Dhe prandaj përdoret ky term.

23 PY. Kur thoni që duhet "një kënd i caktuar", a mund të na e
24 shpjegoni për çfarë këndi e keni fjalën?

25 PË. Është këndi i djathtë, mund të jetë më i madh ose më i

1 vogël, më i vogël se sa 45 për qind. Megjithatë, ai lidhet me
2 pikën hyrëse në skalp [Sipas përkthimit], në një kënd të
3 caktuar.

4 PY. Tani në transkript thuhet që është një kënd "më i vogël
5 se sa 4 apo 5 për qind", në faqen -- kjo jepet në rreshtin 19,
6 në faqen 54. Tani dua që t'ju pyes, Dëshmitar, në qoftë se kjo
7 shifra është e saktë apo dëshironi që të thoni diçka tjetër?
8 Është pasqyruar saktë kjo, apo jo? A mund të na shpjegoni se
9 në çfarë këndi duhet që të hyjë plumbi në mënyrë të tillë që
10 lëndimi të quhet lëndim në formën e vrimës së çelësit të
11 derës?

12 PË. Mund të jetë 45 ose 50 për qind, ndonjëherë është më pak
13 se sa 40 për qind [Sipas përkthimit]. Duke vazhduar më tej, në
14 qoftë se një kënd i tillë nuk është shumë i mprehtë, ose nuk
15 është shumë i madh, atëherë disa prej fakteve të shkaktuara
16 prej lëndimeve me plumba, janë të ashtuquajturat vrima çelësi
17 të zgjatura. Domethënë, me fjalë të tjera, bëhet fjalë për
18 plagë të zgjatura, tangentale, ndonjëherë janë plagë të
19 zgjeruara, të kockave, të eshtrave të skalpit të kokës. Janë
20 lëndime tangentale, ndonjëherë quhen plumba që janë në trajtën
21 e vrimave të gjata të formave të çelësit të derës.

22 ZNJ. WYLER: [Përkthim] A mund t'i kërkoj përkthyesit që
23 të mund të na e sqarojë pak sepse në transkript e kemi "4 ose
24 5", ndërkohë që me atë çfarë dëgjova që thatë juve më herët,
25 m'u duk sikur thatë "40 deri në 50", ose "45".

1 PËRKTHYESI: Jo, është 45 gradë, pra ky është, kjo është.
2 Ky është madhësia e këndit.

3 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit. Kaq pyetje kisha.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Pak a shumë domethënë, këndi është
5 45 gradë. Mund të jetë maksimumi deri në 50.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përfunduat?
7 Doni të filloni ju, Rowan?

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po, faleminderit.

9 Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan:

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

11 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Në këtë rast, juve ju është kërkuar
12 nga Prokuroria që të shikoni mbi 50 raporte autopsie.

13 Domethënë, me fjalë të tjera, po flasim për një material, një
14 sasi të konsiderueshme materiale. Kështu që do t'ju kërkoj
15 që të na sqaroni disa çështje, disa pika. Megjithatë, nuk
16 pretendoj që, ose nuk planifikoj të paktën që të marr shumë
17 kohë marrja ime në pyetje.

18 Si temë fillestare, a pajtoheni me mua që është e saktë
19 që në momentin kur ju kryeni autopsi në mbetje skeletore, ju
20 jeni më i kufizuar se sa në rastin kur merreni me kadavra të
21 freskëta që kanë akoma indet e buta të paprekura? Pra, a është
22 më e vështirë që të trajtoni autopsi vetëm me mbetjet
23 skeletore?

24 PË. Në morg ne kemi marrë trupa që na sillen ose transmetohen
25 zakonisht në qese plastike. Kushtet e këtyre trupave janë të

1 ndryshme, domethënë ndryshon situata nga një rast te tjetri.

2 Por, si informacion i përgjithshëm duke iu referuar këtui
3 nivelit të kalbëzimit dhe ndryshimeve pas vdekjes të
4 kadavrave, informacioni zakonisht, ky lloj informacioni
5 vendoset në faqen e parë të raportit. Dhe në këtë pjesë të
6 raportit përshkruhet kushtet në të cilat neve e marrim trupin
7 në morg.

8 PY. Po, ekzaktësisht, kjo është situata. Dhe këtë në fakt e
9 keni identifikuar dhe në raportin tuaj. Megjithatë, në
10 përgjithësi unë duhet t'ju pyes edhe një herë dhe t'ju them që
11 si patolog ju jeni më i kufizuar në punën tuaj në qoftë se
12 ekzaminoni vetëm thjesht eshtrat e skeletit dhe nuk ka inde të
13 buta të pranishme në trupin e vdekur. A është kështu, apo jo?

14 PË. Po. Koment i saktë është ky. Në shumë raste në raportet e
15 mia, në përfundimet përmbyllëse të raporteve, unë shkruaj
16 përgjithësisht se për shkak të kalbëzimit pas vdekjes,
17 lëndimet e indeve të buta ose për shembull si rezultat i
18 sëmundjeve të organeve të brendshme, aspekte të caktuara nuk
19 mund të vlerësohen. Kjo do të thotë se përfundimet e mia
20 mbështeten vetëm mbi analizën që unë bëj të mbetjeve skeletore
21 të kadavrave. Dhe me të drejtë, më duhet të them që në rastin
22 kur bëhen analiza mbi këto mbetje skeletore, situata dhe puna
23 ime është më e kufizuar.

24 PY. Është e drejtë, apo jo, që edhe në disa raste që keni
25 shqyrtuar, ju nuk keni pasur as grupin e plotë të mbetjeve

1 skeletore, por thjesht jeni mbështetur tek një pjesë e
2 eshtrave të mbetura, ose të mbetjeve skeletore, a është e
3 vërtetë kjo?

4 PË. Kur kam marrë në tavolinën time, kur marr, për shembull,
5 një qese plastike me trupin e vdekur të një pacienti, para se
6 ta hapësh qesen plastike unë nuk e kam idenë se çfarë ka aty
7 brenda. Shpeshherë mund të jepen ca pjesëza eshtrash, ose
8 vetëm një numër i caktuar eshtrash, ose ndonjëherë ndodh që të
9 jetë trupi i plotë i pacientit. Zakonisht, kjo pasqyrohet në
10 raport. Domethënë në qoftë se skeleti ka qenë i plotë, i
11 pacekur, apo jo. Në shumë raste ajo çfarë marr unë për të bërë
12 vlerësimin, është vetëm thjesht një copë eshtre.

13 PY. A është e vërtetë që thuajse 26 raste nga të cilat ju
14 keni vlerësuar, pra, a keni mbërritur ju në më shumë sesa 26
15 raste në përfundimin që shkaku i vdekjes nuk mund të
16 përcaktohej mbi bazën e materialit që keni këqyrur?

17 PË. Në disa raporte të miat, ka ndodhur që raporti të jetë i
18 përqendruar tek një kockë, tek një eshtër. Kështu që çfarë
19 mund të them unë në qoftë se vlerësimi bëhet vetëm mbi një
20 eshtër?

21 PY. Në këto rrethana keni qenë i kufizuar, kështu që me
22 përvojën që keni, me ekspertizën që keni, nuk e keni pasur
23 mundësinë që të arrini në përfundime se çfarë e ka shkaktuar
24 vdekjen e personit të vdekur, kështu?

25 PË. Në qoftë se nuk e kam në dispozicion të tërë skeletin dhe

1 në një situatë kur kam thjesht një eshtër ose një pjesë të një
2 eshtre të trupit për të këqyrur, për të ekzaminuar, unë e kam
3 pasur të pamundur që të jap me vërtetësi se cili ka qenë
4 shkaku i vdekjes.

5 PY. Do t'ju pyes lidhur me disa prej autopsive që keni kryer
6 në 2005. A ju kujtohet se në maj të 2005 për shumë autopsi,
7 autopsinë me juve e kanë bërë, e keni bërë me dy profesorë
8 serbë? Pra, një profesor që quhej Vuledin Dobivic [Sipas
9 përkthimit] edhe një profesor tjetër serb?

10 PË. Ata kanë qenë vëzhgues, domethënë, ka pasur herë pas here
11 vëzhgues që vinin nga Serbia. Për shembull, profesor Otasovic.
12 E përmendët, e dëgjova këtë emër. Ishin dy patologë serbë.

13 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Atëherë, për të na ardhur në
14 ndihmë do i kërkoja Sekretarisë së pari që të na tregojë
15 njërin prej këtyre autopsive. Për këtë arsye, do i lutesha
16 Sekretares që të paraqiste në ekran dokumentin SPOE00068515,
17 deri në 00068520.

18 PY. Doktor, tani do ju tregojmë njërin prej atyre autopsive
19 që janë bërë gjatë kësaj periudhe, dhe pasi të shfaqet në
20 ekran, do t'ju bëj pyetjen e radhës. Mund ta shohim në ekran
21 këta personat, nuk do e përmend emrin, por gjithsesi mund të
22 shikoni emrin e personit të autopsisë në numrin e referencës.
23 E thashë dhe njëherë që nuk do e them, nuk do e paraqes.

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Atëherë, shikojmë pak faqen
25 tjetër, që është faqja 519.

1 PY. Atëherë, dua t'ju konfirmoj sepse e cekët sipërfaqësisht.

2 Ju thatë që:

3 "Autopsia është kryer së bashku me dy profesorë serbë

4 ..."

5 Dhe këtu jepen emrat e tyre. A mund ta shikoni këtë
6 informacion, e shikoni këtë informacion nën pikën A, sa për
7 procesverbal? E konfirmoni dot, Dëshmitar?

8 PË. Këta janë dy emra të dy profesorëve serbë të cilët shumë
9 shpesh kanë qenë në statusin e vëzhguesit, domethënë, kanë
10 qenë vëzhgues në procesin e kryerjes së autopsisë. Këta dy
11 emra janë përmendur në këtë raport.

12 PY. Mbase mund të nënkuptohet prej pyetjes tuaj, megjithatë,
13 ajo çfarë është e rëndësishme për mua është që të më sqaroni
14 rolin që kanë luajtur ata. A është e vërtetë, është e saktë të
15 thuhet që ata thjesht ju kanë vëzhguar juve gjatë kryerjes së
16 autopsisë, ndërkohë që autopsinë në vetvete e keni kryer ju,
17 sikurse thuhet në këtë pjesë të raportit? A është kjo situata?

18 PË. Në përgjithësi, është e saktë.

19 PY. Pjesëmarrja e tyre është përmendur prej jush në shumë
20 autopsi në shumë raporte që keni shkruar, pra autopsi të
21 kryera gjatë kësaj periudhe kohore. A është e saktë që
22 ndërkohë që ju keni shkruar që ata kanë qenë të pranishëm, në
23 secilën prej rasteve kur kanë qenë të pranishëm, ata kanë qenë
24 thjesht si vëzhgues, pra nuk e kanë kryer ata autopsinë, është
25 e saktë të thuhet kjo?

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 65

1 PË. Në përgjithësi, është e saktë.

2 PY. Pra, konstatimet dhe përfundimet në këto autopsi janë
3 konstatimet dhe përfundimet tua, kështu i takon, apo jo,
4 Dëshmitar?

5 PË. Po, është e saktë, janë përfundimet e mia.

6 PY. Faleminderit. Tani do kalojmë te një tjetër raport i
7 juaj. Shpresoj të na ndihmosh që të sqaroj një tjetër temë.

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Për këtë arsye, do i kërkoja
9 Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin SPOE000208422 deri
10 në 00208440.

11 PY. Në mes të faqes, jepet emri i një personi, autopsinë e të
12 cilit ju e keni bërë, tek rreshti i dytë. Domethënë ky është
13 personi i vdekur, autopsinë e të cilit ju keni bërë.

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares të
15 paraqesë faqen që përfundon me 438. Faleminderit.

16 PY. A e njihni këtë si një prej raporteve autopsish të kryer
17 prej jush, Dëshmitar? E shihni besoj nënshkrimin në fund, apo
18 jo?

19 PË. Është nënshkrimi im në këtë faqe. A mund ta lexoj pak
20 këtë raportin? Po, është nënshkrimi im.

21 PY. Faleminderit. Të shohim pak së bashku rreshtin e parë. Ju
22 këtu thoni se në këtë rast ju po merreni me:

23 "Mbledhjen tërësisht të skeletonizuar dhe të shpërberë të
24 eshtrave të paktën 6 individëve të rritur."

25 A e shikoni këtë rreshtin, këtë fjalinë?

1 PË. Po, e shikoj këtë pjesë të tekstit.

2 PY. A e kuptoj drejt unë që atë ditë ajo çfarë keni këqyrur
3 juve apo çfarë keni pasur përpara në tryezën e punës kanë qenë
4 të paktën 6 skelete? A është kështu?

5 PË. Po, këtë gjë thotë raporti.

6 PY. Mund të shohim gjithashtu që ju keni thënë që gjatë
7 autopsisë janë marrë 47 kampionë të ndryshëm nga eshtrat në
8 mënyrë të tillë që të bëhet testi i ADN-së. Ky është
9 informacion që mund ta lexojmë në fjalinë e dytë. A thotë
10 kështu fjalia e dytë, Dëshmitar?

11 PË. Po, përsëri kështu thuhet në raport.

12 PY. A mund të supozojmë prej këtu që në kohën kur ju keni
13 kryer këtë autopsi, ju nuk e keni ditur dhe në fakt askush nuk
14 e dinte se mbetjet e kujt, eshtrat e kujt po këqyrnit apo po
15 ekzaminonit në atë kohë? A mund të thuhet kjo, Dëshmitar?

16 PË. E vetmja gjë që unë mund të them është që bëhej fjalë për
17 eshtra, për mbetje të trupave njerëzorë.

18 PY. Në qoftë se do vazhdoj më poshtë në tekst, është një
19 fjali që vijon. Nuk e di në qoftë se e ndiqni raportin apo jo.
20 Atëherë, thuhet që:

21 "Tregohen lëndime të cilat janë në përputhje me ato
22 shenjat që mund të lënë të shtënat me armë zjarri në pjesën e
23 djathtë ..."

24 E shikoni, është një rresht më poshtë?

25 PË. Po.

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 67

1 PY. Pra:

2 "Në pjesën e djathtë të skapulës thuhet në raport janë
3 shkaktuar këto lëndime."

4 A është e vërtetë kjo?

5 PË. Po.

6 PY. Këtu thuhet që:

7 "Pjesa tjetër e eshtrave nuk tregojnë shenja të qarta të
8 lëndimeve pas vdekjes, ose *ante-mortem*."

9 PË. Kjo do të thotë që nuk ka lëndime ose shenja të tjera të
10 lëndimeve të cilat mund të sugjerojnë se cila ka qenë shkaku i
11 vdekjes, apo jo.

12 PY. Atëherë, ajo çfarë thuhet këtu është që për ADN-në,
13 pavarësisht nëse kujt i përkiste skapula, ajo çfarë
14 nënkuptohet për këtë pjesë të raportit është që shkaku ka qenë
15 nga armët e zjarrit, domethënë, e shtënë me armë të zjarrit në
16 pjesën e gjoksit, në pjesën e krahavorit. Dhe bëhet fjalë që
17 është dëmtuar vetëm kjo kockë, domethënë, konstatimi është
18 vetëm për këtë lloj eshtre, apo jo?

19 PË. Shkaku i vdekjes i referohet vetëm këtij rasti.

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që në këtë
21 dokument të shfaqë në ekran faqen që përfundon me 437.

22 PY. Atëherë, të kujtojmë, Dëshmitar, që kemi pasur një emër
23 kur e hapëm për herë të parë këtë dokument, pra mund të
24 shikoni emrin e personit të vdekur. Mund të shikojmë
25 gjithashtu edhe certifikatën e vdekjes dhe këtu thuhet që

1 shkaku i vdekjes është i pasigurt, nuk është vërtetuar me
2 siguri. E shikoni këtë pjesë, apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Kështu thuhet në raport.

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mund ta lëmë këtë dokument në të
5 majtë ose në të djathtë të ekranit në gjysmën e ekranit, dhe
6 përveç këtij dokumenti do kërkoja që të paraqitet në ekran
7 dokumenti SITF00180714 deri në 000180738.

8 PY. Atëherë, Dëshmitar, do të shfaq në ekran dëshminë e një
9 antropologu, pra antropologu e ka emrin [Shënim i përkthyesit:
10 Përkthyesja nuk e kapi emrin e antropologut]. A është ky një
11 person të cilin ju e keni parë, që keni punuar në Kosovë?

12 PË. E keni fjalë për antropologun Baraybar?

13 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk e mora përgjigjen e
14 dëshmitarit.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, Pablo Baraybar ka qenë shefi
16 im.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

18 PY. Atëherë, në qoftë se do shkojmë tek dokumenti, tek
19 rreshti i parafundit, pra, thuhet që dëshmitari është Pablo
20 Baraybar, dhe ky është dëshmi e dëshminë -- dëshmisë së tij në
21 një proces gjyqësor të brendshëm në Kosovë në vitin 2005. Pra,
22 sa për t'ju shpjeguar se çfarë bëhet fjalë në dokumentin që
23 keni në të majtë të ekranit.

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në këtë dokument kërkoj që të
25 paraqitet faqja që përfundon me 719. Atëherë, të shohim

1 gjysmën e dytë të faqes. Do i kërkoja Sekretares ta zmadhojë
2 pak në mënyrë të tillë që t'i vijë pak më shumë në ndihmë
3 dëshmitarit. Do ishte mirë që edhe pyetja edhe përgjigjet të
4 shfaqen në të gjithë ekranin. Ju lutem, edhe pyetjen edhe
5 përgjigjen, nëse është e mundur.

6 PY. Sa për ta kuptuar ju, Dëshmitar, a e shikoni pyetjen që
7 bën Prokurori? Prokurori thotë:

8 "Le të diskutojmë raportin tuaj lidhur me personin ..."

9 Emri i personit jepet edhe në të djathtë të ekranit, se
10 nuk duam që ta përmendim emrin. E shikoni këtë, apo jo,
11 Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 PY. Do t'ju lexohet dhe çfarë ka thënë në, dëshmitari, lidhur
14 me këto kampionë. Pra thuhet që:

15 "Mbetjet e këtij personi janë gjetur fillimisht në
16 varrezat e përmendura aty, përmes zhvarrimeve të TPNJ-së në
17 vitin 2000. Sigurisht, në kohën e zhvarrimeve, TPNJ-ja nuk e
18 dinte se kujt i përkisnin mbetjet në atë çantë plastike. Ajo
19 çfarë u vu re në, aty ishte që bëhej fjalë për një qese
20 plastike që përmbante mbetjet e të paktën pesë personave, dhe
21 se këto mbetje i ishin nënshtruar një autopsie të mëparshme
22 dhe disa prej tyre eshtrave tregonin që kishin shënime, dhe
23 kishin shenja të lëndimeve përmes armëve të zjarrit, pra
24 plumbave. Këto mbetje ishin rivarrosur dhe nuk ishin
25 identifikuar, dhe ishin rizhvarrosur përsëri në vitin 2003."

1 Më pas vazhdohet më tej dhe thotë që:

2 "... ne kemi mbledhur 47 kampionë ADN-je në mënyrë të
3 tillë që të themi që një krah dhe një këmbë ishin pjesë të të
4 njëjtë individ. Megjithatë ne kemi mbledhur gjithashtu edhe
5 kampionë nga skapula dhe eshtra e shpatullës së djathtë, sepse
6 përmes këtyre eshtrave ne kemi konstatuar një eshtër të
7 shpatullës së djathtë që kishte pësuar një qëllim me plumb dhe
8 kishte një lëndim të tillë, sepse kjo mund të ishte lëndim
9 vdekjeprurës për shkak se në goftë se dikush qëllohet në
10 skapula, atëherë plumbi ka shumë të ngjarë që të kalojë përmes
11 mushkërive dhe që të shkatërrojë tërësisht arterien aty."

12 Pyetja që kam për juve, Dëshmitar, është kjo: A e
13 përshkruani dhe ju një situatë të tillë në raportin tuaj?
14 PË. Po. Situata është e njëjtë.

15 PY. Pastaj antropologu vazhdon që:

16 "Ne kemi marrë rezultate, rezultatet e ADN-së që lidhin
17 disa kampioneve, 47 kampioneve të ADN-së me z.", dhe nuk po e
18 përmend emrin, "në fakt 7 nga 47 kampione i përkisnin këtij
19 personi. Për t'ju dhënë një ide për riasociimin për të cilin
20 po flasim ... Po flasim për lidhjen e femurit dhe të eshtrave
21 të tjera."

22 Atëherë, po ashtu, thuhet që:

23 "Nuk mund të vërtetohet shkak i vdekjes së këtij
24 personi, në veçanti për shkak të faktit që e vetmja eshtër
25 ishte skapula dhe të gjitha eshtrat që ne kemi këqyrur, kemi

1 ekzaminuar, nuk tregojnë se ka pasur lëndim dhe për këtë arsye
2 shkaku është i pavërtetueshëm sepse skapula nuk mund të lidhet
3 me asnjë person.”

4 A e shikoni këtë pjesë të raportit, Dëshmitar?

5 PË. Nuk e kuptoj dot.

6 PY. Mirë, do ta lexojmë dhe një herë tjetër, për ta kuptuar.

7 Doktor, keni mundësi, dini të lexoni anglisht? Sepse raporti
8 është në anglisht.

9 A mund ta lexoni vetë paragrafin e fundit, dhe
10 shqyrtojeni dhe bisedojmë prapë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ngadalësoni
12 pak ritmin se po flisni në të njëjtën kohë me njëri-tjetrin.

13 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

14 PY. Doktor, ndoshta do t’jua them ndryshe. Në raportin tuaj
15 ju keni konstatuar që i vetmi, e vetmja është që kishte plagë
16 që mund të kishte shkaktuar vdekjen, ishte shkak -- skapula,
17 është saktë?

18 PË. Saktë.

19 PY. Në kohën kur keni bërë autopsinë nuk dihej se kujt ishte
20 kjo pjesë, kjo është e skapulës.

21 PË. Saktë.

22 PY. Asnjë nga kockat e tjera nuk kishte plagë që mund të
23 kishte shkaktuar vdekjen, saktë?

24 PË. Kështu, ky është përfundimi në raport.

25 PY. Këtu kemi disa informacione shtesë që Baraybar jep si

1 dëshmi dhe ku thotë që është, janë bërë analizat e ADN-së dhe
2 7 nga 47 kampionë të ADN-së që janë marrë identifikonin
3 personin që është, me emrin që ka këtu. E shikoni këtë? Është
4 rreshti i dytë në paragrafin e dytë.

5 PË. Po, e shoh.

6 PY. Tani, nga kjo, a pajtoheni bazuar në këtë që disa prej
7 eshtrave identifikojnë, janë të personit, pra, që kemi këtu,
8 në bazë të testeve ADN?

9 PË. Kështu thuhet në raport.

10 PY. Në rreshtin e fundit thotë, që:

11 "Skapula, pra eshtra skapula, aty ku kishte një plagë,
12 nuk mund të lidhej me personin që kemi këtu."

13 E shihni këtë?

14 PË. Po.

15 PY. Pra, në qoftë se kalojmë tani prapë te certifikata në
16 anën e djathtë, atëherë, a ka kuptim që në qoftë se skapula,
17 eshtra e skapulës nuk është e këtij njeriu, nuk e dimë shkakun
18 e vdekjes, sepse nuk është e tij kjo kockë?

19 PË. Analizat e ADN-së a kanë përcaktuar, identifikuar, se e
20 kujt është kjo eshtër e skapulës?

21 PY. Siç e shihni në të majtë të ekranit, i vetmi informacion
22 që kemi nga Dr. Baraybar është që kjo skapula, pra kjo eshtër,
23 nuk mund të identifikohet si e askujt. Pra, kuptojmë që kjo në
24 vitin 2005 nuk mund të lidhej me asnjë person. Ajo që dimë
25 megjithatë, është që kjo kockë, kjo eshtër, nuk është e

1 identifikuar si e personit që është, emri i të cilit e shohim
2 në të djathtë, bazuar në këtë dëshmi. Pajtoheni me këtë?

3 PË. Kampionët, janë marrë mostrat e ADN-së. Janë marrë
4 kampionë mostra të ADN-së nga skapula. Tani pyetja është e
5 kujt është kjo eshtër e skapulës?

6 PY. Kjo është pyetja që kemi edhe ne, nuk kemi përgjigje për
7 këtë. Por ajo që po ju pyes unë është, lidhur me këtë person,
8 nuk më intereson se e kujt është. Unë po ju, thjesht dua të
9 merrem me këtë personin që kemi këtu në anën e djathtë. A
10 pajtoheni që nuk është e atij dhe për rrjedhojë nuk ka kuptim
11 të thuhet që kjo është, është plotësisht e kuptueshme të themi
12 që është shkaku i vdekjes së tij është, i pavërtetuar, i
13 papërcaktuar.

14 PË. Përgjigjja mund të jepet vetëm pasi të mund të bëhet
15 ekzaminimi i rezultateve të ADN-së.

16 PY. A po thoni që nuk e pranoni dëshminë e Dr. Baraybar siç e
17 lexuam? Që nuk e pranoni përshkrimin e tij të rezultateve të
18 ADN-së?

19 PË. A mund ta shoh raportin? Dhe ekzaminimin, analizën e ADN-
20 së të eshtrës së skapulës nga raporti im del që është marrë
21 një kampion i ADN-së.

22 PY. E vetmja plagë vdekjeprurëse që ju keni identifikuar në
23 këto, në tërësinë në këtë koleksion, pra, grup eshtrash, ka
24 qenë se, ka qenë kjo, skapula. Në skapula, pra, në këtë
25 eshtër, a është e saktë?

1 PË. Kjo është përfundimi në raportin tim.

2 PY. Faleminderit.

3 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në qoftë se mund të përqendrohemi
4 pak më shumë, të zmadhojmë dokumentin në anën e djathtë, ju
5 lutem. Pak më poshtë. Në të njëjtën faqe, por në fund të
6 faqes. Faleminderit.

7 PY. Ky dokument ju është treguar juve nga Prokuroria kur jeni
8 takuar me ta gjatë seancës përgatitore, ju kujtohet?

9 PË. Po, më kujtohet.

10 PY. Dhe keni parë që nënshkrimi në këtë faqe nuk është i
11 juaji, apo jo?

12 PË. Nuk është nënshkrimi im.

13 PY. Dhe nuk ishit në gjendje të shpjegoni pse kjo ishte
14 nënshkruar nga dikush tjetër me emrin tuaj, është kështu?

15 PË. Nuk kam mundësi t'i përgjigjem kësaj pyetjeje.

16 PY. Nuk ju kujtohet të keni autorizuar apo t'i keni kërkuar
17 dikujt tjetër që të nënshkruajë këtë në emër tuaj?

18 PË. Nuk më kujtohet.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] A mund të kalojmë tek një dokument
20 tjetër tani? Do kërkoja të shfaqim në ekran dokumentin IT-03-
21 66 P228.

22 PY. Edhe ky është dokument që ju është treguar në seancën
23 përgatitore, Doktor, ju kujtohet që e keni parë?

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në qoftë se mund ta zmadhojmë pak
25 dhe të shohim pjesën e fundit -- ta zvogëlojmë.

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, ky është nënshkrimi im.

2 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

3 PY. A është e saktë që i keni thënë Prokurorit lidhur me këtë
4 dokument që duket që ju keni nënshkruar këtë për Dr. Morcillo,
5 dhe për rrjedhojë ka shumë gjasa që ajo ta ketë bërë autopsinë
6 që ju keni nënshkruar dhe ju keni nënshkruar certifikatën e
7 vdekjes në emër të saj? Kështu i keni thënë Prokurorisë në
8 seancën përgatitore?

9 PË. Kështu duket.

10 PY. Dhe është e saktë që sot juve nuk ju kujtohet tani në
11 këtë çast nuk keni kujtesë të këtij rasti në veçanti? Këtij
12 rasti konkret?

13 PË. Nuk më kujtohen rrethanat që kanë të bëjnë me këtë
14 çështje, me këtë rast.

15 PY. Pra, nuk keni, nuk jeni në gjendje të shpjegoni pse ju
16 keni nënshkruar në emër të saj apo pse, apo keni, nëse keni
17 luajtur apo keni patur ndonjë rol në këtë autopsi, a keni
18 marrë pjesë?

19 PË. Nuk jam në gjendje t'i përgjigjem kësaj.

20 PY. A është e drejtë të themi që ju keni nënshkruar atë në
21 emër të saj dhe në qoftë se ajo e ka bërë autopsinë, ju keni
22 besuar gjetjet, konstatimet, përfundimet e saj dhe keni
23 nënshkruar certifikatën e vdekjes në emër të saj?

24 PË. Unë kam besuar në përfundimet e arritura nga doktori i
25 mjekësisë ligjore i cili ka bërë këtë autopsi.

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 76

1 PY. Faleminderit.

2 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] A mund të shfaqim në ekran tani

3 SITF00030155 deri në SITF00030184 RED2?

4 PY. Doktor, këtu e shikoni fillimin e një raporti të

5 autopsisë, i shkruar me dorë, saktë?

6 PË. Po, është dorëshkrim. Nuk është dorëshkrimi im.

7 PY. Po, kjo autopsi është bërë nga Dr. Ong?

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë tek

9 faqja që përfundon me 0159.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Data është 25 qershor.

11 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

12 PY. Dhe sipër saj shohim emrin e Dr. Beng Ong. E shikoni

13 këtë?

14 PË. O-n-g.

15 PY. A pajtoheni që mund të konsiderojmë që, duke qenë që

16 përmbledhja është në emër të tij dhe autopsia ka gjasa të jetë

17 bërë nga ai, pra dhe autopsia të jetë bërë nga ai meqenëse

18 është në emër të tij?

19 PË. Ky raport çon në këtë konstatim apo mendim.

20 PY. E dimë, pra, që raporti nuk është raport i juaj, dhe ju

21 nuk e njihni dorëshkrimin aty. A është kështu?

22 PË. Saktë.

23 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kalojmë në faqen që përfundon me

24 0811 [Sipas përkthimit]. Ta zvogëlojmë pak dhe të shohim

25 pjesën në fund të faqes.

1 PY. E shohim nënshkrimin tuaj në këtë certifikatë vdekjeje?

2 PË. Po, viti 2002. Është nënshkrimi im.

3 PY. Atëherë, a mund të supozojmë që njëjtë si autopsia e
4 fundit që sapo pamë, që ju keni parë, shqyrtuar, raportin e
5 kolegut tuaj Ong, keni besuar në përfundimet, gjetjet e tij
6 dhe e keni nënshkruar atë. A është kështu?

7 PË. Mund ta përshkruajmë kështu.

8 PY. Faleminderit.

9 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] A mund të shfaqim në ekran
10 SITF00169843 deri në 00169851 RED?

11 PY. Dhe shohim personin me të cilin po merremi, që është në
12 pjesën e sipërme. Ky është ekzaminimi që dua të merrem me të.

13 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mund të kalojmë te faqja 9849.

14 PY. Dhe këtu mund të shohim që, iniciale, është ky nënshkrim,
15 dorëshkrimi juaj apo jo? Apo dikush tjetër e ka shkruar në
16 emër të juaj?

17 PË. Ky është dorëshkrimi im.

18 PY. Dhe shkaku i vdekjes që keni dhënë ju këtu në mes të
19 faqes është goditje me armë zjarri në kokë dhe në gjoks.

20 PË. Kokë dhe gjoks. Kjo është në raport, po.

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të kalojmë, në faqen tjetër, të
22 shohim raportin e autopsisë. Në fund të faqes kemi gjetjet,
23 konstatimet.

24 PY. Tani dua të përqendrohem tek plaga në trup, dhe ju keni
25 renditur këtu:

1 "Plagë në brinjë, në anën e majtë që prekin brinjët 6, 7,
2 8, 9, 10, dhe 11.

3 "Plaga është në përputhje me të shtënë me armë zjarri
4 ..."

5 E shikoni këtë?

6 PË. Po, e shoh në këtë faqe.

7 PY. A është e saktë siç e shohim këtu, që plaga ka prek disa
8 brinjë që plaga, pra, që ju keni vërejtur, a është kështu?

9 PË. Nga përshkrimi rezulton që plagët e brinjëve janë
10 shkaktuar nga të shtëna me armë zjarri, që janë në, ndjekin
11 një trajektore tangjenciale në trup, me trupin, në pjesën e
12 sipërme të trupit, dhe plagët në brinjë.

13 PY. Unë, pyetja ime kishte të bënte me numrin e brinjëve që
14 janë prekur nga kjo plagosje, nga ky lëndim. Kemi pra disa
15 brinjë të prekura.

16 PË. Nga raporti rezulton se 6 brinjë janë lënduar në anën e
17 majtë.

18 PY. Dhe kjo është një sipërfaqe që shkon deri në 10
19 centimetra, siç e keni konstatuar ju në rreshtin e fundit,
20 është kështu?

21 PË. Plagët gjenden 6 deri në 10 centimetra nga shtylla boshti
22 kurrizor, pra, që është --

23 PY. Në raportin tuaj ju konstatoni se plaga, siç e përmendët,
24 përputhet me të shtëna me armë zjarri. Ky është konstatimi
25 juaj?

1 PË. Po, është në përputhje me të shtëna me armë zjarri.

2 PY. A pajtoheni që edhe pse është në, përputhet me të shtënat
3 me armë zjarri, nuk është e mundur të përjashtohet tërësisht
4 që këto plagë të jenë shkaktuar nga një impakt, nga një
5 goditje e fuqishme, me send të fortë?

6 PË. Në raportin tim kam shënuar, e shtënë me armë zjarri ose
7 goditje me një lloj këndi. Pra, këto janë lëndime që përputhen
8 me të shtëna me armë zjarri nga një goditje që vjen nga një
9 kënd jo i drejtë, dhe shkakton lëndime në brinjë.

10 PY. Që të jem e qartë, nuk po kundërshtojmë faktin që këto lë
11 lëndime janë në përputhje, përputhen me të shtënat me armë
12 zjarri. Ajo që po ju them është që përveç kësaj, nuk është e
13 mundur të përjashtohet tërësisht që këto lëndime mund të ishin
14 shkaktuar nga një goditje me send të fortë, pra që nuk është e
15 mundur të përjashtohet kjo tërësisht si alternativë?

16 PË. Ka më shumë gjasa që të ketë qenë një e shtënë me armë
17 zjarri.

18 PY. Që të jemi të qartë nuk mund ta përjashtoni si mundësi,
19 si shkak i mundshëm, që të ketë qenë një impakt nga goditja me
20 send të fortë.

21 PË. Ka jashtëzakonisht pak gjasa që këtë lëndime të jenë
22 shkaktuar nga diçka tjetër përveç të shtënës me armë zjarri.

23 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mund të shfaqim në ekran
24 dokumentin, t'ju jap -- SITF00019793 deri në 8110 [Sipas
25 përkthimit] kjo është tërësia e dokumentit.

1 PY. Doktor, ajo që do shfaqim tani në ekran janë fotografi që
2 ju treguan më herët nga Prokurori.

3 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] A mund të shfaqim në ekran tani
4 dokumentin, faqen që përfundon me 798?

5 PY. Ju kujtohet kjo, që e keni parë më herët?

6 PË. Kjo fotografi është bërë gjatë hetimit dhe të ekzaminimit
7 të pacientit.

8 PY. Po. Në dëshminë tuaj sot në mëngjes, duke u përgjigjur
9 pyetjeve të Prokurorit, juve, ishte që të, shenjat e, në trup,
10 të prerjeve që shohim këtu, sipas fjalëve të tua, mund të
11 jenë shkaktuar nga djegia e cigareve. Është e saktë?

12 PË. Shkaku i këtyre lëndimeve mund të jetë i ndryshëm, por
13 një prej shkaqeve të mundshme mund të jetë djegia e cigares,
14 që krijon rezultate të tilla.

15 PY. A mund, a pajtoheni me mua që kur shihen lëndime të
16 shkaktuara nga djegia e cigareve, atëherë personi vuan një --
17 ka një shenjë që është si në formë krateri, pra që ngelet mbi
18 lëkurë si rezultat i mekanizmit, i këtij mekanizmi?

19 PË. Koment i saktë. Megjithatë, këto lëndime dhe këto djegie
20 të shkaktuara nga djegia e cigares mbi trup pra, ndonjëherë
21 këto shkaktajnë dhe infeksione, dhe në këto raste këto vraga
22 kanë formë jo të rregullt dhe janë më të mëdha. Ajo që ka
23 ndodhur në këtë rast, vragat këtu, të identifikuara, këto janë
24 identifikuar dhe mund të jenë si rezultat i lëndimeve të
25 tilla.

1 PY. A është e saktë të kuptojmë dëshminë tuaj që ju pajtoheni
2 me qëndrimin se një person, se pritët, lloji i vragës që
3 pritët të gjendet në një person që është djegur me cigare
4 është, ka formën e një krateri. Natyrisht që në disa raste
5 mund të gjejmë dhe forma të tjera të vragës.

6 PË. Në qoftë se s'ka patur infektim, irritim, atëherë po.

7 PY. Pajtoheni që personi që e keni ekzaminuar, nuk keni
8 gjetur vragat në formë të kraterit?

9 PË. Unë -- unë kam parë, gjetur, këto vrage siç janë në këto
10 fotografi, dhe i kam shënuar në raport, siç janë përshkruar
11 aty.

12 PY. A do të them me përgjigjen tuaj që kjo do të thotë jo? Do
13 të kuptoj këtë gjë, domethënë, që nuk keni gjetur të tilla?

14 PË. Në qoftë se një vend ku digjet me cigare mbi trup, pastaj
15 ka infeksion, atëherë vrage ka formë të parregullt, siç e ka
16 inflamacion pra, shihet ka formë të parregullt, siç shihet në
17 fotografinë këtu. Dhe nga përvoja ime e di që djegiet shërohen
18 në forma të ndryshme, kryesisht, veçanërisht ato që janë
19 djegie të shkaktuara nga cigarja.

20 PY. Faleminderit.

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Do të shfaqim tani një dokument
22 tjetër në ekran përpara pushimit të drekës. Dokumenti
23 SITF00175086 deri në SITF00175147.

24 PY. Doktor, ky është, kjo është një autopsi mbi të cilën ju
25 bënë pyetje më herët.

1 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në këtë raport do kërkoj faqen

2 5104.

3 PY. Kjo është autopsia e bërë nga Dr. Francmann. Ju kujtohet
4 që ju bënë pyetje më herët lidhur me këtë?

5 PË. Po, më kujtohet.

6 PY. Që të sqarojmë qëndrimin tuaj lidhur me këtë autopsi, ju
7 sot këtu, juve nuk ju kujtohet kjo autopsi konkretisht?

8 Mendoj që nuk kemi marrë përkthimin akoma. Që ta
9 qartësojmë kjo autopsi konkrete nuk ju kujtohet sot, që jeni
10 këtu?

11 PË. Nuk më kujtohet kjo autopsi në hollësi.

12 PY. Siç i shpjeguat Prokurorisë -- siç ia shpjeguat
13 Prokurorisë më herët, juve ju kujtohet që keni qenë i
14 pranishëm pothuajse për të gjitha autopsitë e bëra nga Dr.
15 Francmann. Por nuk mund të jeni i sigurt nëse keni qenë i
16 pranishëm apo jo për këtë.

17 PË. Gjatë punës time për këtë organizatë, zakonisht kam qenë
18 i pranishëm në morg, gjatë pjesës dërmuese të autopsive që
19 janë bërë aty.

20 PY. Sigurisht, zakonisht keni qenë aty dhe keni qenë aty për
21 pjesën më të madhe të autopsive që ajo ka bërë. Por, sot që
22 jeni këtu, në këtë moment, nuk mund të jeni i sigurt që keni
23 qenë i pranishëm për këtë autopsi?

24 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Kundërshtim. Kjo pyetje u bë dhe
25 përgjigjja u mor.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
2 përgjigjet.
3 Vazhdoni.
4 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk më kujtohet kjo autopsi në
5 veçanti.
6 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]
7 PY. Atëherë, a është e drejtë, Doktor, ta themi që kur keni,
8 kur dhatë, kur keni dhënë dëshmi lidhur me autopsi në të
9 kaluarën, në Kosovë, dhe kur ju, kur dhatë dëshmi sot këtu për
10 këtë autopsi, ajo që po na jepni neve është një analizë
11 eksperti e një autopsie siç e keni lexuar atë, a është kështu?
12 PË. Ky është informacion që kam dhënë bazuar në raportin e
13 autopsisë.
14 PY. Pra, dëshmia juaj nuk bazohet në konstatimet dhe gjetjet
15 tua, të cilat do t'i kishit arritur po ta kishit bërë ju
16 këtë autopsi. Ajo që ju keni bërë, keni lexuar autopsisë e një
17 personi tjetër, dhe keni bërë komente mbi gjetjet dhe
18 konstatimet, që ju keni parë në këtë raport, a është kështu?
19 PË. Unë dhashë këtë informacion, bazuar në raportin e
20 autopsisë i përpiluar nga personi që ka bërë autopsinë, dhe
21 personi që ka shkruar këtë raport, pra.
22 PY. Dhe njësoj siç ishte rasti me autopsitë e tjera që
23 shqyrtuam, ju keni besuar konstatimet, përfundimet dhe gjetjet
24 si të sakta?
25 PË. Në këtë rast, autopsia është bërë nga një profesor dhe

1 përfundimet janë shkruar në raport, dhe kjo është baza për
2 mua.

3 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Më ka mbetur një dokument, nuk e
4 di a mund ta trajtojmë tani apo mund ta bëjmë pas kthimit nga
5 pushimi?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se,
7 a mendoni që mund të përfundoni brenda pesë minutash?

8 Më falni?

9 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Varet nga përgjigjet që marr. Mund
10 të më duhen 10 minuta.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
12 tani do të bëjmë pushimin e drekës, një orë e gjysmë. Dhe do
13 të kthehemi në orën 14.30.

14 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për arsye
15 planifikimi a mund të dimë se sa kohë do t'u duhet ekipeve të
16 tjera?

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Për sa më takon mua, më ka ngelur
18 vetëm një dokument.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
21 mund të vazhdoni tani.

22 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mendoja që mund ta përfundoja
23 brenda më pak se dhjetë minutash. Është -- kjo është e bazuar
24 në mënyrën si, këtë vlerësim e bazoj në mënyrën se si shkoi me
25 dokumentet e tjerë, por është thjesht një dokument.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, znj.

2 Tavakoli?

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk mendoj se do kem pyetje.

4 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk do kemi pyetje.

5 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi pyetje as ne.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
7 ndërpritet.

8 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

9 --- Seanca rifillon në orën 14.30

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
11 sillni dëshmitarin në sallë.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se u
14 kthyer, Doktor. Znj. Rowan ka disa pyetje, ju lutem dëgjojeni
15 me vëmendje.

16 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

17 PY. Doktor, dua të shohim dhe një dokument tjetër dhe do
18 përfundojmë.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ju lutem të vendosim në ekran
20 materialin SPOE00212978 deri në SPOE00213007, faqen 2, ju
21 lutem. Ose më saktë, shkojmë në faqen tjetër që të orientohemi
22 fillimisht. Shikojmë certifikatën e vdekjes fillimisht.

23 PY. Në krye të faqes është personi në fjalë. Dëshmitar, e
24 shihni emrin e një personi në krye të faqes? Ju lutem mos e
25 lexoni me zë.

1 PË. Shoh emrin, mbiemrin dhe raportin e tetë.

2 PY. Do merremi me shtatën në këtë paketë dokumentesh.

3 PË. Po, shtata, shtata, po.

4 PY. A e kuptojmë drejt ne këtë listë numrash, pra? Pra, po
5 bëhet fjalë FKT dhe pas FKT-së është një numër, dhe secili
6 prej numrave i korrespondon një raporti, apo e kam --

7 PË. Po prandaj janë këto shënime këtu. Kështu kuptohet.

8 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shkojmë në faqen e dytë, ju lutem,
9 të certifikatës. Këtu.

10 PY. Shohim shkakun e vdekjes dhe këtu shkakun i vdekjes i
11 papërcaktuar.

12 PË. Po, i papërcaktuar.

13 PY. Tani, unë dua të shohim çfarë kemi këtu sepse është disi
14 e paqartë për ne. Dhe uroj të na ndihmohet që t'i sqarojmë disa
15 aspekte.

16 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] I kthehem në fillim dokumentit në
17 faqen e dytë. E zvogëlojmë që ta shohim dokumentin të plotë.

18 PY. Këtu në krye të faqes shohim numrin FKT, siç pamë edhe
19 tek certifikata e vdekjes, gërmat më saktë, kodin FTK, saktë?

20 PË. FKT20/034BP.

21 PY. Shohim këtu që shkakun i vdekjes është i papërcaktuar.

22 PË. Ky raport lidhet me ekzaminimin të një pjese. Ka qenë
23 pjesa e një -- ka qenë një pjesë e femurit -- ka qenë eshtra e
24 kofshës.

25 PY. Do flasim për raportin për një çast. Shohim një herë

1 raportin në tërësinë e vet dhe pastaj flasim për përmbajtjen e
2 raportit.

3 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shkojmë ju lutem në faqen tjetër.

4 PY. Shohim këtu autopsinë tuaj.

5 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Dhe një faqe tjetër.

6 PY. është një raport i dytë autopsie. Në rregull?

7 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] E zvogëlojmë që të duhet faqja e
8 plotë.

9 PY. Po këtu është kodi FKT20?

10 PË. Po, FKT20/156BP.

11 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kalojmë faqen.

12 PY. Këtu kemi detajet.

13 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Edhe një faqe tjetër.

14 PY. Ky është një raport tjetër, FKT20 edhe ky.

15 PË. FKT20/157BP.

16 PY. Nuk dua t'i shohim të shtatë. Po a është e saktë që kemi
17 shtatë raporte veçmasi autopsie për fragmente të ndryshme të
18 eshtrave?

19 PË. Këto raporte mbulojnë -- kanë lidhje me eshtrat
20 njerëzore.

21 PY. Pajtohem. Nëse dëshironi ne i shohim raportet edhe një
22 për një. Po a është e saktë që për pesë nga shtate raporte të
23 autopsisë në këtë dosje shkaku i vdekjes është i papërcaktuar?

24 PË. Kështu thuhet në raport.

25 PY. Atëherë, a mund të supozojmë ne me të drejtë se kur morgu

1 ka marrë mbetjet njerëzore në ato momente nuk dihej nëse këto
2 mbetje i përkisnin të njëjtit person, sepse po ta dinin
3 personat e morgut që i përkisnin të njëjtit person, këto
4 eshtra do ishin bashkuar në një grup të vetëm.

5 PË. Këto janë procedurat.

6 PY. Po unë dua të më ndihmoni ju, që ju të ma shpjegoni çfarë
7 mund të ketë ndodhur në këtë rast që ta kuptojmë ne pse kemi
8 disa raporte dhe nuk kemi një raport të vetëm.

9 Tani, për dy nga raportet, në dy nga raportet jepet
10 shkaku i vdekjes, apo jo? Për shembull, në ekran e kemi
11 shkakun e vdekjes së personit që është dëmtimi i vertebrës
12 lumbare, saktë?

13 PË. Po kështu thuhet në raport.

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] E shohim edhe një herë
15 certifikatën e vdekjes që është në faqen e parafundit besoj.
16 Faleminderit.

17 Më intereson të shoh datën e raportit, duhet të jetë diku
18 ku është nënshkrimi.

19 PY. Data është 2012 poshtë majtas jepet data. A e shihni në
20 dokument?

21 PË. E shoh, e shoh në dokument.

22 PY. Shohim kryen e dokumentit. Në krye të dokumentit të
23 gjitha fragmentet e eshtrave i janë atribuar personit që
24 shohim në krye të faqes. E shohim emrin në krye të faqes.
25 Mendohet që i përkasin këtij personi. A e kuptoni dhe ju

1 kështu?

2 PË. Kështu duhet kuptuar. Në qoftë se ekzaminimi i ADN-së e
3 ka konfirmuar se në të vërtetë eshtrat i përkisnin personit në
4 fjalë.

5 PY. Dhe ky informacion nuk është ditur -- nuk ka qenë i ditur
6 në vitin 2005 kush është bërë autopsia, apo jo?

7 PË. Sikurse ua thashë më herët, ne kemi marrë kontejnerë
8 plastikë, qese plastike në të cilat ishin vendosur eshtrat dhe
9 ato kemi ekzaminuar.

10 PY. Po a mund të supozojmë ne që disa vite pasi është kryer
11 autopsia dhe pasi janë marrë rezultatet e ADN-së, atëherë
12 është lëshuar certifikatë ADN-je për këtë person dhe të gjitha
13 gjetjet janë grumbulluar në një dokument të vetëm, certifikatë
14 vdekje desha të thoja. Pra, është lëshuar certifikata e
15 vdekjes, desha të thoja, për këtë person.

16 PË. Po, certifikata e vdekjes.

17 PY. Do ta bëj edhe një herë pyetjen. Doktor, a mund të themi
18 ne kështu: Është bërë autopsia e parë në 2005. Më pas u
19 dërguan mostrat e ADN-së për testim. Kur u morën rezultatet e
20 ADN-së në 2012, një person atëherë ka lëshuar një certifikatë
21 vdekje ku ka përfshirë ADN-në dhe certifikatën që ne po shohim
22 përpara, të dhënat që ne po shohim përpara në një certifikatë
23 të vetme.

24 PË. Duke lexuar raportin, kështu kuptohet kjo.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shohim fundin e certifikatës. Këtu

1 shohim emrin tuaj.

2 PY. Këtu shohim emrin tuaj, po jo nënshkrimi juaj, apo jo?

3 PË. Jo, nuk është nënshkrimi im.

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër, ju lutem.

5 Të shohim nënshkrimin në fund.

6 PY. Edhe këtu është emri juaj i shtypur, por jo nënshkrimi
7 juaj, apo jo?

8 PË. Ky nuk është nënshkrimi im.

9 PY. Pra, ju aktualisht nuk na e shpjegoni dot pse ka
10 nënshkruar dikush në emrin tuaj në 2012?

11 PË. Nuk mund t'i përgjigjem kësaj pyetje. Certifikata e
12 vdekjes është lëshuar më 3 prill 2012. Unë kam punuar deri në
13 fund të qershorit 2012.

14 PY. Ju i keni thënë Prokurorisë se mbase mund ta ketë
15 nënshkruar Dr. Barbu, kështu?

16 PË. Ka qenë grua, ka qenë femër, në fakt.

17 PY. Dr. Barbu ka qenë femër?

18 PË. Më duket se po. Emri i korrespondon mbiemrit që përmendi
19 ju.

20 PY. Dr. Barbu, atëhere ka qenë një patologe që punonte në
21 Kosovë?

22 PË. Ka qenë një zonjë që ka punuar për një periudhë të
23 caktuar kohore në Kosovë, në territorin e Kosovës.

24 PË. Patologe ka qenë?

25 PË. Mjek i kriminalistikës.

1 PY. Domethënë, a ishte patologe apo jo kur thoni ju "i
2 kriminalistikës mjeko-ligjore", a ka qenë patolog, patologe?

3 PË. Po, mund ta themi dhe këtë.

4 PY. Po sipas jush çfarë kualifikimesh kishte ky person kur
5 keni punuar së bashku?

6 PË. Jo kështu e kam kuptuar dhe unë.

7 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shohim fillimin e faqes ku thuhet
8 se shkak i vdekjes është i papërcaktuar.

9 PY. A mund të themi atëherë që Dr. Carmen Barbu, kur e ka
10 nënshkruar këtë dokument do ketë qenë dhe personi që ka thënë
11 se shkak i vdekjes ka qenë i papërcaktuar?

12 PË. Po, kështu thuhet në raport.

13 PY. Atëherë, në këtë rast me të drejtë mund të supozojmë se
14 ajo ka analizuar shtatë raportet që keni përgatitur ju në atë
15 kohë. A mund ta supozojmë këtë?

16 PË. Nga sa po kuptoj unë prej këtij raporti, po. Kjo zonjë
17 është njohur me përmbajtjen e raporteve, përfshirë
18 FKT20/157BP. Në këtë raport ka qenë i përmendur shkak i
19 vdekjes.

20 PY. Tani dua të flasim në fakt për shkakun e vdekjes.

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shohim faqen që përfundon me numër
22 2999. Edhe e zmadhojmë.

23 PY. Ky është një nga raportet ku jepet shkak i vdekjes. Në
24 krye shohim që është bërë autopsi që i është bërë femurit,
25 pjesës qendrore dhe të djathtë të femur. Pra, nëse e kuptojmë

1 drejtë, është analiza që i është bërë eshtrës së kofshës, apo
2 jo?

3 PË. Po, kështu thuhet në raport.

4 PY. Dhe ju këtu keni thënë, plagë me armë zjarri në kofshën
5 djathtë, saktë?

6 PË. Kështu thuhet në raport.

7 PY. Shohim faqen tjetër sepse kemi gjetje më të shtjelluara.

8 Doktor, ky ka qenë vetëm një mbetje skeletore. Atëherë, a
9 është e vërtetë që nuk keni pasur mundësi të shihni indet
10 vaskulare, apo indet e buta kur keni kryer ekzaminimin tuaj?

11 PË. Më lejoni, ju lutem, t'ju hedh një sy shënimeve në faqen
12 e parë. Ka informacion atje ku thuhet në çfarë gjendje ishin
13 eshtrat.

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Okej, në rregull, shkojmë një faqe
15 më lartë.

16 PY. Këtë faqe doni të shikoni?

17 PË. Po. I skeletonizuar, thuhet, totalisht i skeletonizuar.
18 Dhe thuhet "Nuk ka pasur inde të buta". Ç'ka do të thotë, nuk
19 ka pasur inde, po vetëm mbetjet skeletore.

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të kthemi në faqen që ishim, ju
21 lutem.

22 PY. A është e vërtetë, atëherë, që duke mos pasur inde të
23 buta dhe sistemin vaskular ju nuk keni qenë në gjendje të
24 ekzaminonit lëndimin që u kishte shkaktuar indeve të buta apo
25 sistemit vaskular arma e zjarrit?

1 PË. Nuk ka pasur inde të buta, kështu që nuk kanë qenë në
2 materialin që më duhej mua për të kryer analizat. Kështu që
3 nuk jam në gjendje të them se në çfarë gjendje kanë qenë indet
4 e buta.

5 PY. Tani në një situatë të tillë, nëse një person gjuhet me
6 armë zjarri në këmbë, në rrethana normale personi mund të
7 mbijetojë. A pajtoheni me mua?

8 PË. Plaga me armë zjarri -- armë zjarri, më falni, është në
9 pjesën e sipërme të eshtrës së femurit, në kofshë, eshtra e
10 kofshës. Këtu është evidente se ka një mangësi me një diametër
11 prej pothuajse 7, 8 milimetra me zgjerim krateri dhe kjo
12 përputhet me plagën e armës së zjarrit që fillon në të
13 djathtën dhe vijon në të majtën. Nga e djathta në të majtë.

14 PY. Po siç e keni thënë ju në raportin tuaj, duke mos pasur
15 inde të buta, por thjesht një pjesë të femurit, ju nuk mund të
16 vlerësonit me siguri dëmin që ka shkaktuar plaga, për
17 shembull, në organe ose në pjesën pelvike apo dëmin që mund
18 t'i jetë shkaktuar arteries sepse nuk ishin të pranishme
19 organet apo indet e buta, në mënyrë që ju të bënit analizat
20 përkatëse?

21 PË. Ju keni të drejtë, po duhet të keni parasysh po ashtu
22 cilat organe janë në pjesën proximale të eshtrës së dëmtuar,
23 afër eshtrës së dëmtuar dhe cilat enë gjaku gjenden pranë
24 kësaj eshtre.

25 PY. Sigurisht që ky mund të jetë një shkak i mundshëm i

1 vdekjes dhe ka mundësi që të ketë qenë fatale për personin
2 plaga e armës së zjarrit. Por a pajtoheni ju me mua, se bazuar
3 në informatat në dispozicion që keni pasur ju, thjesht keni
4 pasur vetëm eshtrën e femurit, nuk mund të dilet në konkluzion
5 përfundimtar për shkakun e vdekjes, por mund të jetë një shkak
6 i mundshëm vdekje? Pra, plaga me armë zjarri mund të ketë qenë
7 një nga shkaqet e vdekjes apo shkak i mundshëm i vdekjes?
8 PË. Nga ky përshkrim mund të themi se lëndimet me shumë të
9 ngjarë ka qenë *ante-mortem* apo *peri-mortem*, para vdekjes, pra.
10 Në periudhën që i parapriu vdekjes në këtë zonë ku është
11 përcaktuar fakti që ka pasur plagë me armë zjarri, ka edhe enë
12 gjaku që janë vitale dhe një dëmtim i këtyre enëve të gjakut
13 mund të ketë shkaktuar, duhet të ketë shkaktuar dëmtim të
14 sistemit kardio-vaskular, i cili zakonisht shkakton një vdekje
15 të shpejtë të pacientit, sjell në vdekjen e shpejtë të
16 pacientit.

17 PY. Sigurisht që është e mundur dhe unë e kuptoj që ju po
18 thoni që mund të jenë dëmtuar këto enë gjaku. Por, a mund të
19 pajtoheni -- a pajtoheni ju me mua, në fakt, që në mungesë të
20 indeve të buta, ju nuk mund të thoni me siguri se ka pasur
21 dëmtim të këtyre enëve të gjakut?

22 PË. Sipas anatomisë, anatomisë së trupit të njeriut, në këtë
23 pjesë ka enë gjaku, arterie, vena. Dhe një dëmtim i eshtrës në
24 këtë vend të trupit mund të dëmtojë indet që gjenden aty
25 pranë, përfshirë këtu enët e gjatë.

1 PY. Por jo domosdoshmërisht në të gjitha rrethanat mund ta
2 shkaktojnë vdekjen? Pra, jo në të gjitha rrethanat, në
3 rrethana të caktuara, mbase.

4 PË. A shohim anatominë e trupit të njeriut? Ka enë gjaku
5 vitale që furnizojnë pelvisin dhe kofshën me gjak. Dëmtimi i
6 eshtrës të çon në përfundimin se janë dëmtuar indet në atë
7 pjesë të trupit. Kështu që, logjikisht dëmtimi i eshtrës në
8 atë pjesë të trupit dëmton indet e buta, përfshirë arterien,
9 vënien arteriale dhe venët e gjakut.

10 PY. Që të jemi të qartë për dëshminë tuaj, pa qenë nevoja të
11 shohim anatominë apo diagramat. Ju po thoni se ky lëndim ka
12 qenë padyshim fatal? Pra, ju po thoni që me siguri për shkak
13 të këtij lëndimi ka vdekur personi? Me "po" ose me "jo".

14 PË. Lëndim -- një lëndim që dëmton indet e buta, përfshirë
15 venat dhe arteriet në çojnë më pas në gjakderdhje, çojnë në
16 vdekjen e një personi.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni
18 trajtuar gjatë këtë pjesë, ju lutem.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

20 PY. A pajtoheni ju me mua se një patolog mund të dilte në një
21 përfundim të ndryshëm lidhur me shkakun e vdekjes?

22 PË. Nuk mund t'i përgjigjem kësaj.

23 PY. Mirë atëherë.

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shohim faqen që përfundon 2922.

25 PY. Do shohim raportin e dytë të autopsisë ku është

1 përcaktuar dhe shkak i vdekjes.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem, nuk kapa
3 numrin e faqes sepse vazhdonte përkthimi.

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Është në të njëjtin grup
5 dokumentesh, po përfundon me numrin 2992, faqja 6.

6 PY. Shohim eshtrat që janë përdorur për këtë autopsi. Kemi
7 osakrum, lef koksa [Sipas përkthimit] edhe kemi vertebrën
8 lumbare. I shihni?

9 PË. Kështu thuhet në raport.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë në faqen tjetër ku
11 të shohim gjetjet. Ndalojmë këtu, ju lutem. Po ju lutem ta
12 nxirrni dokumentin e plotë.

13 PY. Në gjetjet tuaja do shohim që ka një dëmtim të vjetër në
14 trupin e -- në pjesën e majtë të krahavorit. Është një lëndim
15 që e keni evidentuar ju dhe që ka qenë lëndim i vjetër,
16 kështu?

17 Ju lutem, duhet të përgjigjeni me zë sepse përndryshe nuk
18 zbardhet dhe në transkript. Lëndim të kërbishtes më saktë, jo
19 lëndim të krahavorit.

20 A e shihni dhe ju që keni thënë këtu: Ka një frakturë të
21 vjetër dhe që është shëruar në pjesën e majtë të kërbishtes?

22 PË. Po, është një frakturë e vjetër e anës së majtë të
23 kërbishtit.

24 PY. A e shikoni tek një rresht më përpara çfarë lexohet? E
25 shikoni një rresht më përpara, Dëshmitar? Thuhet në fund që ka

- 1 një lëndim *ante-mortem* në pjesën e majtë të kërbishtit.
- 2 PË. Kjo një thjesht -- është thjesht një lëndim i ri që
- 3 mbivendoset në lëndimin e mëparshëm dhe tek kjo pjesa jepet
- 4 përshkrimi i këtij lëndimit të ri. Kjo ka ndodhur *ante-mortem*.
- 5 PY. *Ante-mortem* domethënë është përpara vdekjes sipas
- 6 mendimit tuaj, Dëshmitar?
- 7 PË. Po, përpara vdekjes.
- 8 PY. E kam kuptuar siç duhet?
- 9 PË. Po, e keni kuptuar drejtë, para vdekjes.
- 10 PY. Pra, ju thoni që janë identifikuar dy lëndime këtu,
- 11 domethënë, është një lëndim i vjetër dhe lëndimi i vjetër
- 12 është një frakturë e vjetër e shëruar në të majtë të
- 13 kërbishtes dhe më pas domethënë e mbivendosur është gjithashtu
- 14 dhe një lëndim tjetër i veçantë i paidentifikuar, në të majtë
- 15 po ashtu.
- 16 PË. Këtu kështu thuhet në këtë raport.
- 17 PY. Megjithatë këtu vetëm thjesht përmendet lëndimi dhe nuk
- 18 jepet ndonjë përshkrim i natyrës së lëndimit, apo jo,
- 19 Dëshmitar? Është e saktë kjo?
- 20 PË. Kështu rezulton nga raporti. Këtë thotë raporti.
- 21 PY. Një patolog tjetër që e lexon këtë raport, jo në mënyrë
- 22 të domosdoshme mund ta identifikojë natyrën e lëndimit duke
- 23 marrë si bazë atë çfarë përshkruhet këtu. Domethënë, mund të
- 24 presupozohet që është frakturë, por gjithsesi kjo nuk thuhet
- 25 shprehimisht në këtë pjesë të raportit, apo jo, Dëshmitar?

1 PË. Nuk mund të përgjigjem në emër të patologëve të tjerë ose
2 të mjekëve të tjerë forensikë. Në raportin tim, juve sapo
3 lexuar atë që unë kam konstatuar gjatë procesit të autopsisë.
4 Domethënë, unë e kam bërë të ditur atë çfarë kam konstatuar
5 gjatë këtij procesi. Kjo është përgjegjësi të cilën e marr unë
6 përsipër.

7 PY. Në rregull. Të shikojmë numrin 1. Të shohim cila është
8 formulimi, cila është gjuha që e keni përdorur nën numrin 1.
9 Ne e dimë që në konstatimet tuaja, sepse tek pika 1 flitet për
10 vertebrat lumbare. Ju thoni që mund -- ka shumë të ndodhur që
11 lëndimi të ketë ndodhur *perimortem*. A e shikoni këtë,
12 Dëshmitar? Është në fund të fjalisë në kllapa.

13 PË. Po.

14 PY. *Perimortem* do të thotë rreth kohës së vdekjes, ose pak
15 përpara vdekjes ose pak pas vdekjes. Është e vërtetë kjo?

16 PË. Po. *Ante-mortem* ose *perimortem*.

17 PË. Sa i takon përkufizimit të *perimortem*, *perimortem* do të
18 thotë si term, pra përkufizimi i termit është periudhë që
19 është ose pak përpara sesa të vdesë personi ose pak përpara
20 sesa -- pasi të ketë vdekur. Domethënë, ose pak para ose pas
21 vdekjes, apo jo?

22 PË. Këto janë terma të cilat janë shumë të ngjashme. *Ante-*
23 *mortem* dhe *perimortem* janë shumë të ngjashme.

24 PY. Si e përkufizoni ju *ante-mortem* -- *perimortem*.

25 PË. Pra, të lidh -- e lidhur me vdekjes. Domethënë, mund të

1 ndodhë ose pak përpara ose pak pas vdekjes. Sikurse e thashë
2 dhe më përpara këto janë terma të cilat janë shumë të
3 përngjashme në përkufizim, në kuptim.
4 PY. Por, këtu e keni bërë dallimin, keni thënë "me
5 probabilitet ose me gjasa *perimortem*". Domethënë, mënyra se si
6 e keni dhënë formulimin ju këtu do të thotë që ka qenë një
7 konstatim që është i mundur, nuk është me siguri që mund të
8 ketë ndodhur kështu, apo jo? kështu e lexoni dhe ju,
9 Dëshmitar?

10 PË. Po, unë këtu them "me probabilitet ose me gjasa
11 *perimortem*".

12 PY. Dhe duke bërë dallimin, për shembull, me atë çfarë keni
13 përshkruar më sipër, pra, kur nuk bëhet, ju nuk bëni -- nuk
14 jepni të njëjtin formulim, pra ju nuk është se bëni --
15 domethënë nuk është se ka siguri nga ana jua sa i takon kohës
16 kur ka ndodhur një lëndim i tillë, apo jo, pra, fakti që keni
17 dhënë këtë formulim tregon që nuk jeni i sigurt 100 për qind,
18 apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Po, mund ta shoh këtë.

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja e fundit.
21 E thashë gabim, një faqe më përpara nëse është e mundur. Kjo
22 është pyetja ime e fundit.

23 PY. Shohim shkakun e vdekjes. Këtu shkakun e vdekjes është
24 dëmtim i kërbishtes dhe i vertebrës lumbare. Duke marrë
25 parasysh që vertebra, domethënë lëndimi në vertebrën lumbare

1 është identifikuar si një dëmtim që ka gjasa që të ketë
2 ndodhur *perimortem* dhe duke marrë parasysh gjithashtu edhe
3 lëndimin në kërbishtë që identifikohet si i ri dhe i vjetër, a
4 pajtoheni me mua që një mjek tjetër patolog që do e lexonte
5 këtë raport disa vite më pas, mund të arrijë në përfundimin që
6 ky lëndim nuk është shkak përfundimtar vdekje, por është shkak
7 i mundur vdekje?

8 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Është pyetje sugjestionuese.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka nga e
10 di dëshmitari se çfarë mund të mendojë një tjetër patolog.

11 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

12 PY. Do ja u bëj ndryshe pyetjen. Dëshmitar, a pajtoheni me
13 mua se duke pasur parasysh se ka mungesë të indeve të buta
14 gjatë këqyrjes së këtyre trupave dhe duke marrë parasysh
15 gjithashtu dhe konstatimin tuaj që lëndimi në vertebrën
16 lumbare mund të thuhet që ka të ngjarë që të ketë ndodhur
17 vetëm *perimortem*, këto rrethana a mund të çojnë në përfundimin
18 që kjo mund të jetë një shkak i mundur i vdekjes, por nuk mund
19 të thoni në mënyrë përfundimtare ose me 100 për qind siguri që
20 ka qenë shkak i vdekjes ky? A pajtoheni me mua lidhur me
21 këtë, Dëshmitar?

22 PË. Unë mbaj përgjegjësi për raportet e mia dhe për shkaqet e
23 vdekjeve të përmbajtura në këto raporte. Nuk mund të jap
24 komente për patologë të tjerë. Këto janë konstatimet e mia
25 gjatë proceseve të autopsisë.

1 PY. Dëshmitar, nuk ju kërkoja të më thoni se çfarë do
2 mendonte një patolog tjetër por çfarë ju pyeta ishte kjo, që
3 duke marrë parasysh faktin që ju e keni bërë këtë autopsi dhe
4 keni vepruar në një situatë ku nuk keni pasur individ të butë,
5 nuk keni pasur gjithashtu dhe një sistem vaskular dhe po ashtu
6 duke marrë parasysh konstatimet tuaja që lëndimi rreth
7 vertebrës lumbare, që keni thënë që ka të ngjarë të ketë
8 ndodhur *perimortem* dhe duke folur rreth këtyre gjetjeve
9 faktike në këtë raporte, a pajtoheni me mua që nuk mund të
10 thoni dot me siguri që shkak i vdekjes është lëndimi në
11 vertebrën lumbare? Pajtoheni me mua apo jo?

12 PË. Gjatë autopsisë duke marrë parasysh lëndimet që unë i kam
13 shqyrtuar dhe i kam këqyrur si shkaqe të mundshme vdekje, nuk
14 ka dëshmi të shërimit të eshtrës. Kjo do të thotë që këto
15 lëndime janë shkaktuar pak kohë përpara vdekjes, shumë pak
16 kohë përpara vdekjes.

17 PY. Po. Po a pajtoheni me mua që nuk thoni dot me vërtetësi
18 që ky lëndim ka shkaktuar vdekjen dhe që ky person, për
19 shembull, mund të ketë vdekur nga një shkak tjetër, që mund të
20 ketë qenë, për shembull, një plumb në kofshë?

21 ZNJ. WYLER: [Përkthim] U pyet dhe e morët përgjigjen.

22 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ju lutem, më lejoni që të
23 përfundoj fjalinë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] U bë disa
25 herë kjo pyetje dhe mori përgjigjet e veta. Nuk do merrni më

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan

Faqe 102

1 përgjigje tjetër nga ky dëshmitar.

2 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Me ç'kuptoj kundërshtimi u pranua,
3 apo jo?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, në të
5 vërtetë.

6 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në rregull. Nuk kam pyetje të
7 tjera për këtë dëshmitar.

8 PËRKTHYESJA: Ekipet e tjera të Mbrojtjes nuk kanë më
9 pyetje për dëshmitarin.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokurore,
11 keni pyetje plotësuese.

12 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje plotësuese.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Doktor,
14 përfunduar me dëshminë tuaj. E përmbushët detyrimin që keni
15 përpara Trupit Gjykses. Tani mund të largoheni. Nuk e keni më
16 të nevojshme të qëndroni këtu. Do të largoheni në shoqërinë e
17 Sekretares.

18 Faleminderit që ishit me ne. Ju urojmë gjithë të mirat në
19 të ardhmen.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit shumë.

21 [Dëshmitari largohet]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jeni gati me
23 dëshmitarin tjetër? Na duhet ca kohë që të përgatitemi kështu
24 që do bëjmë një pushim prej 30 minutash. Në rregull, do bëjmë
25 20 minuta pushim. Të shohim në qoftë se mund të përgatitemi

1 për këtë kohë.

2 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se
3 është e mundur dua që të them shkurtimisht sa i takon edhe
4 dëshmitarëve të tjerë që kërkojmë që të shtyhet pak afati sa i
5 takon parashtime të radhës për t'ju përgjigjur kërkesave të
6 Prokurorisë. A është e mundur që të na zgjasni afatin deri të
7 premtën?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

9 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] E për këtë dëshmitar? Në rregull.
10 Shumë mirë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po Prokurorja
12 kur e keni gati? Jeni në gjendje që të jepni dokumentet tuaja
13 në këtë ditë?

14 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Po, nuk kam problem fare.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
16 atëherë. Do të keni mundësi që t'i përgjigjeni parashtimeve
17 të Prokurorisë deri të premtën, ekipet e Mbrojtjes.

18 Do bëjmë pushim për 20 minuta.

19 --- Seanca ndërpritet në orën 15.12

20 --- Seanca rifillon në orën 15.32

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
22 uleni.

23 Përpara se të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit të
24 Prokurorisë W04743 ka disa çështje paraprake që Trupi Gjykses
25 dëshiron të trajtojë.

1 Zonja asistente e seancës, ju lutem na sillni në seancë
2 private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
4 jemi në seancë publike dhe konfirmoj që masat mbrojtëse për
5 dëshmitarin janë hequr dhe duke filluar nga ky moment
6 dëshmitari do japë dëshmi pa shtrembërim të zërit dhe të
7 figurës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
9 znj. Sekretare.

10 Dëshmitar, tani jemi gati për të filluar me dëshminë
11 tuaj. Do ju kërkoja të ngriheshit në këmbë tani, Dëshmitar.
12 Sekretarja do t'iu japë tekstin e betimit solemn që do të
13 duhet ta lexoni në pajtim me rregulloren tonë. Më konkretisht
14 Rregulla 141(2). Ju lutem hidhini një sy dokumentit dhe më pas
15 lexojeni me zë atë.

16 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
17 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
18 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe
19 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

20 DËSHMITARI: NASER KRASNIQI

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
22 Dëshmitar. Mund të uleni tani.

23 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që pritet
24 që të zgjasë përafërsisht dy ditë. Sikurse mund ta dini, e
25 para do t'ju bëjë pyetje Prokuroria. Pas Prokurorisë, ekipet e

1 Mbrojtjes kanë të drejtë për t'iu bërë pyetje, ashtu siç edhe
2 anëtarët e Trupit Gjykues mund t'iu bëjnë pyetje, në qoftë e
3 shohin të nevojshme.

4 Prokuroria ka vlerësuar se për t'iu marrë në pyetje i
5 nevojiten tre orë. Ekipet e Mbrojtjes kanë vlerësuar që
6 afërsisht u nevojiten katër orë e 10 minuta, si dhe në raste
7 të tjera, ne shpresojmë që ekipet të jenë efikase sa i takon
8 përdorimit të kohës. Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje
9 plotësuese, në qoftë se përmbushen kriteret për to.

10 Dëshmitar, ju lutem mundohuni të jepni përgjigje pyetjeve
11 me fjali të shkurtra dhe të qarta. Në qoftë se një pyetje nuk
12 e kuptoni, lirisht mund t'i kërkonit avokatit përkatës që ta
13 përsërisë pyetjen ose ty sqarojë atë. Gjithashtu, mundohuni që
14 të jepni bazën e njohurive që keni për faktet dhe rrethanat
15 për të cilat do të pyeteni.

16 Në rast se ZPS-ja ju kërkon që të vërtetoni disa prej
17 korrigjimeve të cilat ju i keni bërë në deklaratën tuaj, ju
18 kujtojmë që duhet të thoni për procesverbal që deklaratat me
19 shkrim, së bashku me listën e korrigjimeve, pasqyrohen në
20 mënyrë të saktë në deklaratën tuaj.

21 Gjithashtu mos harroni të flisni pranë mikrofonit dhe
22 bëni një pauzë prej pesë sekondash përpara se të jepni një
23 përgjigje pyetjes. Po ashtu, duhet të flisni ngadalë për hir
24 të përkthyesve.

25 Ndërkohë që jepni dëshminë në këtë Gjyq, nuk lejohet që

1 ta diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj me ndonjë
2 person jashtë sallës së gjyqit. Nëse dikush nga jashtë sallës
3 së gjyqit ju pyet juve lidhur me dëshminë tuaj, duhet të këtë
4 ta e bëni menjëherë me dije.

5 Nëse ju kërkoj që të ndërprisni së foluri dhe në qoftë se
6 më shikoni që do ngre dorën, ju lutem mos flisni më. Kjo do të
7 thotë që do t'iu -- do të më duhet t'iu jap disa udhëzime
8 shtesë.

9 Nëse e ndjeni të nevojshme për pushime, mund të na e
10 thoni lirisht këtë gjë dhe ne do të bëjmë organizimet
11 përkatëse.

12 Ne jemi në -- të informuar që ju është caktuar një avokat
13 kujdestar, kështu që në qoftë se keni shqetësime legjitime për
14 vetë inkriminim, ose për arsye të tjera, mund t'i drejtoheni
15 këtij avokati.

16 Ju kujtoj, Dëshmitar, që mbështetur në betimin solemn që
17 sapo e lexuat, jeni i detyruar që të tregoni të vërtetën.
18 Sipas rregullores tonë, juve nuk ju kërkohet që të përgjigjeni
19 në një pyetje që është vetëinkriminuese, me përjashtim të
20 rasteve që Trupi Gjykses ju detyron që ta bëni këtë gjë, në
21 përputhje me rregullën 151(2), dhe përcakton që ju jepen
22 garancitë e parashikuara në Rregullën 151(3).

23 Dhe në qoftë se ngrihet një pyetje e tillë që ju
24 vetëinkriminon, avokati juaj ose ju personalisht mund ta
25 ngrini këtë çështje para Trupit Gjykses, ndërkohë që ne do të

1 vendosim në qoftë se po apo jo, apo në cilat rrethana do të
2 detyroheni që të përgjigjeni. Në një rast të tillë, vendimi
3 lidhur me faktin se duhet t'i përgjigjeni një pyetje apo jo,
4 është vendim ekskluziv i Trupit Gjykses -- e Trupit Gjykses.

5 Tani do të fillojmë me pyetjet e Prokurorisë. Prokuroria
6 është e ulur në të majtën tuaj. Ju lutem dëgjojeni me vëmendje
7 Prokurorinë.

8 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

9 DËSHMITARI: A mundem ta paraqes një parashtresë para
10 Trupit Gjykses?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mundeni.

12 DËSHMITARI: Duke pasur parasysh që unë kam qenë pjesëtar
13 i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe përgjigjet që duhet të
14 jap në pyetjet që pritet të më drejtohen, mund të përmbajnë
15 elementë të vetëinkriminimit eventual kërkoj nga Trupi
16 Gjykses që të më garantojë imunitetin e dëshmitarit për
17 mosinkriminim, në përputhje me drejtën time kushtetuese, me
18 Rregulloren e Procedurës dhe Provave, si dhe në pajtim me
19 Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Të faleminderit,
20 Kryetar.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
22 Prokurore, duket sikur dëshmitari kërkon garanci. Prokuroria a
23 ka ndonjë qëndrim lidhur me këtë?

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, ne
25 dëshirojmë të themi që kërkojmë garancitë që parashikohen

1 sipas rregullës 153(b) që t'i -- të miratohen për këtë
2 dëshmitar.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ekipet e
4 Mbrojtjes dëshirojnë që të thonë diçka në lidhje me këtë
5 çështje?

6 Dëshmitar, ju kujtoj që ju jeni thërritur për të dhënë
7 dëshmi dhe duhet që të tregoni të vërtetën. Në të kundërtën,
8 do merren masa ndaj jush. Në qoftë se ju besoni që mund të
9 vetë inkrimihoneni, sikurse e thashë edhe pak më herët, juve
10 mund të thoni që nuk dua t'i përgjigjem pyetjes, por me
11 ç'kuptoj unë ju po kërkon që t'ju jepen garanci, apo jo,
12 Dëshmitar. E kam kuptuar siç duhet qëndrimin tuaj?

13 DËSHMITARI: Po, saktë, Kryetar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Garancia
15 është që ju nuk do të ndiqeni penalisht nga asnjë organ lidhur
16 me dëshminë që ju do të jepni në sallën e gjyqit lidhur me
17 përgjigjet në pyetjet që do t'iu bëhen. A e kuptoni këtë,
18 Dëshmitar?

19 DËSHMITARI: Po, e saktë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
21 Trupi Gjykses ju detyron që të jepni përgjigje pyetjeve, duhet
22 ta bëni këtë gjë. Në qoftë se ju nuk i jepni përgjigje
23 pyetjeve pasi Trupi Gjykses i ka -- ju ka thënë që duhet t'i
24 përgjigjeni pyetjeve, ju mund të me -- ndaj jush mund të
25 merren sanksione ose masa lidhur me këtë. Duhet të keni

1 parasysh që lejoheni që të refuzoni që t'i përgjigjeni
2 pyetjeve në këtë pikë, përderisa juve nuk -- nuk është
3 miratuar kjo kërkesë prej jush.

4 Çfarë -- atëherë kërkesa që ju sapo bëtë, miratohet për
5 juve. A është e qartë kjo për juve?

6 DËSHMITARI: Po, e qartë është.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po avokatin a
8 e keni apo nuk e keni me vete? Nuk e keni?

9 DËSHMITARI: Jo --

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] -- konsultuar
11 me avokatin?

12 DËSHMITARI: Jam konsultuar, por nuk kam dëshiruar të kem
13 avokat.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është e
15 drejta juaj, e vlerësojmë këtë gjë.

16 ZPS-ja tha që ishte dakord që të jepeshin garancitë që ju
17 kërkuat dhe nuk ka kundërshtime për miratimin e garancive,
18 kështu që në pajtim me rregullën 151(2) dhe (3) të
19 Rregullores, këto garanci miratohen për ju, Dëshmitar. Tani do
20 të vazhdojmë më tej me ju.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, me si -- me sa
22 e kuptoj unë rregullat, është që si pasojë e rregullës
23 151(3) (a) dëshmia jepet me dyer të mbyllura.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po dëshmitari
25 ka kërkuar vetë që të jepet me dyer të hapura, pra në seancë

1 publike.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Atëherë qëndrimi juaj është që do
3 përjashtohet kjo mbrojtje që parashikohet sipas rregullës 151?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta pyes
5 dëshmitarin.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, u ngrita për të
7 theksuar që garancitë që jepen nën paragrafin 3(b), sa i takon
8 juridiksioneve jashtë se -- jashtë -- jashtë juridiksioneve
9 besoj që është e rëndësishme që t'i sqarohet kjo çështje
10 dëshmitarit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, juve
12 ju kërkohet -- ju kërkua që të jepni dëshmi në publik.
13 Megjithatë, në qoftë se ju dëshmoni në publik, i takon që mund
14 të thoni gjëra të cilat shkojnë përtej juridiksionit të kësaj
15 Gjykate. E kuptoni këtë, Dëshmitar? A mos do ishte më mirë që
16 të dëshmonit me dyer të mbyllura, domethënë që të mos ju
17 dëgjonte askush tjetër përveç personave që janë në këtë sallë
18 gjyqi?

19 DËSHMITARI: E kuptoj, por dua të dëshmoj në mënyrë
20 publike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ajo çfarë u
22 ngrit që është fakt, garancitë që ne ju japim, aplikohen vetëm
23 për Kosovën dhe për juridiksionin që funksionon kjo Gjykatë.
24 Por në qoftë se dikush në juridiksion tjetër do të përpiqet që
25 të përdorë fjalët tuaja kundër jush, atëherë mund ta bëjnë

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice

Faqe 116

1 këtë gjë dhe për këtë arsye duam t'iu japim mundësinë që ju të
2 jepni dëshminë me dyer të mbyllura, në kuptimin që askush
3 tjetër përveç personave të cilët janë të pranishëm këtu në
4 sallën e gjyqit mund t'iu dëgjojnë. Por ju po hiqni dorë nga
5 kjo e drejtë, apo jo Dëshmitar? Dhe këtë po e bëni me
6 ndërgjegje të plotë dhe në mënyrë vullnetare?

7 DËSHMITARI: Po.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
9 do të vazhdojmë atëherë.

10 Znj. Prokurore? Mund të filloni.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
12 Gjykatës.

13 Pyetje nga znj. Iodice:

14 PY. Mirëdita, z. Krasniqi. Unë quhem Vega Iodice dhe unë do
15 t'ju bëj pyetje ne emër të Prokurorisë sot. Sikurse ua kam
16 shpjeguar edhe gjatë takimit tonë të fundi, në vend të t'ju
17 bëj pyetje rreth çdo teme të cekur në deklaratën tuaj, dhe mbi
18 të cilën ju mu -- keni dhënë dëshminë tuaj, është e mundur që
19 ne të pranojmë disa prej deklaratave tuaja që përmbajnë këto
20 informacione, në prova gjyqësore. Por për ta bërë këtë gjë,
21 është e rëndësishme që të ndryshojë disa hapa proceduralë.
22 Përpara se të fillojmë me hapat proceduralë, do ju kërkoja që
23 të prezantoheshit.

24 Si quheni, emri dhe mbiemri?

25 PË. Naser Krasniqi.

1 PY. Datëlindja juaj, kur është?

2 PË. 11 tetor, viti 1973.

3 PY. Çfarë shtetësie keni?

4 PË. Shtetësinë kosovare.

5 PY. Çfarë niveli arsimor keni?

6 PË. Kam studiuar pas luftës në drejtimin juridik, fakultetin
7 juridik.

8 PY. Faleminderit. Ju i keni dhënë në të shkruarën një dëshmi
9 ZPS-së dhe ju është dhënë mundësia që ta lexonit dëshminë tuaj
10 në seancën përgatitore, për seancën e gjyqit.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares së
12 seancës të paraqesë në ekran dokumentin me ERN 082908-TR-ET
13 dhe përkthimin në shqip të këtij dokumenti.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Cilat faqe, cilat
15 pjesë?

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Vetëm faqen e parë.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të pjesës së parë e
18 keni fjalën?

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po.

20 PY. A ju kujtohet që jeni marrë në pyetje nga ZPS-ja në vitin
21 2019, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. A ju kujtohet se ajo intervistë ka zgjatur rreth dy ditë?

24 PË. Po.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares që të

1 paraqesë në ekran dokumentin SPOE00073919 deri 73199. Ndërkohë
2 që në versionin në shqip dokumenti ka numrin SPOE00073200 deri
3 në 73209.

4 PY. A ju kujtohet që të jeni intervistuar në 12 maj të vitit
5 2011 nga Prokuroria e Kosovës?

6 PË. Po.

7 PY. A ju kujtohet që e keni lexuar këto deklarata që keni
8 dhënë në gjuhën tuaj, përpara një jave?

9 PË. Po, e saktë.

10 PY. A ju kujtohet që ju është dhënë mundësia që të bëni
11 sqarime dhe korrigjime në këto deklarata?

12 PË. Po.

13 PY. A ju kujtohet se korrigjimet janë shkruar në një shënim
14 dhe ju janë lexuar ju?

15 PË. Po.

16 PY. A konfirmoni se ajo çfarë ju është lexuar në atë shënim
17 pasqyron me saktësi dhe plotësisht ndryshimet e bëra prej
18 jush?

19 PË. Po, konfirmoj.

20 PY. Faleminderit. Nëse do të përfshijmë të gjitha korrigjimet
21 dhe sqarimet që keni bërë përpara një jave, informacion në
22 deklaratat tuaja a është i saktë dhe i vërtetë, me aq sa dini
23 dhe besoni ju?

24 PË. Informacion është i saktë dhe i vërtetë.

25 PY. Faleminderit. Në qoftë se sot do ju bëheshin të njëjtat

1 pyetje lidhur me këto ngjarje, a do jepnit të njëjtat

2 përgjigje, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, përderisa
5 janë përmbushur kriteret për rregullën 154, në përputhje me
6 vendimin F02824, paragrafi 24 dhe 25, kërkoj që të pranohen në
7 prova gjyqësore dokumentet 082809-TR-ET, Pjesa 1 deri në 5,
8 dhe fundi është Revised Corrected - pra versioni i rishikuar i
9 korrigjuar si dhe versionin që përfundon me Revised RED dhe
10 përkthimet përkatëse në shqip. Janë 08209-TR-ET, Pjesët 1 deri
11 në. Pjesët 1 deri në 4 kanë gjithashtu shtojcën - prapashtesën
12 Revised Corrected, domethënë versioni i rishikuar i korrigjuar
13 i përkthimit, Revised RED, Pjesa 5, përfundon gjithashtu me
14 Revised RED, si dhe përkthimet përkatëse në shqip.

15 Dëshiroj që të kërkoj që të pranohet si provë gjyqësore
16 gjithashtu edhe dokumenti SPOE00073191 deri 73199, dhe
17 përkthimi në shqip, SPOE73200 deri në 73209.

18 Po ashtu, kërkoj që të pranohet në provë gjyqësore
19 Shënimi Përgatitor 1 me numër ERN120938 deri në 124958.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
21 kundërshtime?

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

23 Z. DIXON: [Përkthim] [sipas përkthimit] Nuk kemi
24 kundërshtime.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Atëherë, dokumenti me numër 082908-TR-ET pjesët 1 deri në 5
2 pranohen.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
4 nderuar Gjykatës. Pjesa 1 e materialit 082908 do të marrë
5 numrin e provës P02006.1. Pjesa 2 do të marrë numrin e provës
6 P02006.2, Pjesa 3 do të marrë numrin e provës P02006.3. Pjesa
7 4 do të marrë numrin e provës P02006.4 dhe Pjesa 5 do të marrë
8 numrin e provës P02006.5, dhe klasifikimi është konfidencial.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Materialet mund të jenë publike.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
11 Riklasifikojini si publike.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me
14 numër 082909-TR-ETR pjesët 1 deri në 6 pranohen.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Pjesa 1 e materialit
16 082909 do të marrë numrin e provës P02007.1; Pjesa 2,
17 P02007.2; Pjesa 3, P02007.3; Pjesa 4 P00 -- më falni P02007.4;
18 Pjesa 5, P02007.5; dhe Pjesa 6, P02007.6. Klasifikimi është
19 konfidencial.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta
21 riklasifikojmë?

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të
24 riklasifikohet materiali si material publik.

25 Materiali SPOE00073191 deri në SPOE00073199 pranohet.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti
2 dhe përkthimi në shqip që mban numrin SPOE00073200 deri në
3 SPOE0073209 [Sipas përkthimit] do të marrë numrin e provës
4 P02008, dhe klasifikimi është konfidencial.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shënimi
6 përgatitor ERN 124938, 124951 pranohet.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimi përgatitor do
8 të marrë numrin e provës P02009 dhe klasifikimi është
9 konfidencial.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A i thashë të
11 gjitha?

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në rregull.

13 Të nderuar Gjykatës, tani do të doja të pranoheshin edhe
14 provat materiale shoqëruese. Përkatësisht faqet që janë pjesë
15 e materialit 082926, 083087. Këto janë. Nga ky material do të
16 doja që të pranoheshin faqet 082926, 082928, 082934, 082937,
17 082989, 083011, 083014 deri në 083015. Më pas 083017 deri në
18 083043.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Provat
22 materiale shoqëruese pranohen.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për sqarim, a mund t'i
24 mbledhim në një dokument të vetëm dhe t'i japim vetëm një
25 numër prove?

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, pa problem.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë dokumenti do të
3 marrë numrin P02010 dhe klasifikimi është konfidencial.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Prova e dytë shoqëruese është
5 082911, 082917 dhe përkthimi në anglisht 082911 deri në
6 082911.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
8 kundërshtime?

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

10 Z. DIXON: [Përkthim] [sipas përkthimit] Nuk kemi
11 kundërshtime.

12 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
14 pranohet dhe ju lutem jepini numrin përkatës.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti në fjalë do
16 të marrë numrin P02011 dhe klasifikimi është konfidencial.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ky po. Po ndërsa materialet e
19 tjera duhet të mbeten konfidenciale orë të mbrojtur palë të
20 treta.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
22 082911, 082917 do të riklasifikohet si material publik.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe prova e fundit shoqëruese
24 është segmenti i një materiali filmik, video dhe ka numrin IT-
25 03-6 [Sipas përkthimi] që është P35. Segmenti kohor është

1 minuta 2, sekonda 46, deri në 03:38, si dhe transkriptimi
2 përkatës që është në faqen 12 në të dyja gjuhët.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
4 kundërshtime për videon dhe transkriptimi përkatës?

5 Palët nuk kanë kundërshtime.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Videoja dhe
7 transkriptimi pranohen.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materiali filmik në
9 shqip dhe në anglisht, bashkë me transkriptimin përkatës do të
10 marrë numrin e provës materiale P02012 dhe klasifikimi është
11 konfidencial.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Materiali mund të jetë publik.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
14 Riklasifikoheni, ju lutem.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit. Tani do të doja t'i
16 bëja disa pyetje dëshmitarit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

19 PY. Z. Dëshmitar, në deklaratën tuaj që tashmë ka marrë
20 numrin e provës P2006.1, faqja 11 dhe 13 ju keni thënë se jeni
21 takuar me Rexhep Selimin, ndryshe Agronin, në Likovc, dhe më
22 pas keni shkuar në Kleçkë. A ju kujtohet kur e keni parë për
23 herë të parë në Kleçkë?

24 PË. Kur e kam parë unë në Likovc, pasi kam mbërritur nga
25 Shqipëria, nuk e kam dit që është Rexhep Selimi. E kam njohur

1 vetëm me emrin Agroni. Më pastaj, në ndërkohë kam mësuar se
2 Agroni është Rexhep Selimi dhe më pastaj, para ofensivës së
3 parë, e kujtoj se së paku një herë e kam takuar në Kleçkë.

4 PY. Faleminderit. Në vitin 1998, kështu?

5 PË. Saktë.

6 PY. Faleminderit. A e dini ju se çfarë bënte ai në Kleçkë,
7 kur e keni parë përpara ofensivës së parë?

8 PË. Nuk e di qëllimin e vizitës së tij në Kleçkë, nuk mund ta
9 them atë se çfarë bënte.

10 PY. A e dini nëse është takuar me ndonjë person?

11 PË. E di që është takuar me Fatmirin, pasi që ishte edhe
12 përgjegjës i pikës aty në Kleçkë.

13 PY. Faleminderit. A mund të na e thoni edhe mbiemrin e
14 Fatmirit ju lutem?

15 PË. Fatmir Limaj.

16 PY. Faleminderit. Sikurse ju thashë më përpara, meqë tashmë
17 është pranuar deklarata juaj, ne do ju bëjmë pyetje konkrete
18 për dëshminë tuaj, çka do të thotë që unë do t'ju ndaloj
19 ndonjëherë kur gjykoj se po shtoni informacione që janë pjesë
20 e deklaratës suaj.

21 Në deklaratën tuaj keni thënë se detyrat tuaja të para
22 kanë qenë detyra të logjistikës dhe të merrnit ushqime dhe
23 furnizime nga populli. Si i mbanit shënim ju personat që
24 dhuronin sende apo ushqim? Si e evidentonit ju këtë?

25 PË. Evidentimi i ndihmave dhe materialeve të ndryshme të

- 1 pranuara në pikën e Kleçkës janë evidentuar përmes disa
2 bllokave paragon që i kemi quajtur atëherë.
- 3 PY. Çfarë lloji -- çfarë lloji re -- çfarë lloji blloku ishte
4 ky. Për shembull, thjesht aty hidhnit çfarë kishit marrë?
5 Çfarë informacioni hidhnit në këtë bllok?
- 6 PË. Po, aty shënohej sasia e saktë që pranohej, emri ose
7 emërtimi i materialit apo i ndihmës që është pranuar, si dhe
8 është vendosur nënshkrimi im aty. Origjinalin e kam ndal për
9 vete apo për pikën, ndërsa kopjen ja kam dhanë palës ose atij
10 personit që ka ndihmuar me ndihma.
- 11 PY. Faleminderit. Ju thatë po ashtu që edhe Sadik Shala
12 merrej me logjistikë. A ju kujtohet nëse ka pasur ndonjë
13 pseudonim?
- 14 PË. Sadik Shala ka pasur pseudonimin Burgija.
- 15 PY. Faleminderit. Do flasim për atë pjesë të deklaratës ku
16 keni përmendur njësitin Lumi, Pëllumbi, Çeliku. Fillimisht unë
17 do t'ju pyes: Ku ka qenë i vendosur njësiti Lumi?
- 18 PË. Njësitin Lumi duhet të ketë qenë i vendosur në Malishevë
19 ose rreth saj.
- 20 PY. A e dini se kush e udhëhoqte?
- 21 PË. Në periudhën që po i referohemi, e di që e ka udhëhequr
22 z. Isni Kilaj.
- 23 PY. Faleminderit. Po njësitin Pëllumbi, kush e drejtonte
24 njësitin Pëllumbi?
- 25 PË. Sipas asaj që unë e di, duhet ta ketë drejtuar z. Ferat

1 Shala.

2 PY. Ju kujtohet ndonjë njësiti tjetër në atë zonë? Ka pas
3 ndonjë njësiti tjetër?

4 PË. Po sigurisht ka pasur, si Lisi, për shembull, si Guri më
5 tutje, si -- ka pasur disa njësiti që tani ndoshta të gjitha
6 nuk mund t'i kujtoj, por ka pasur shumë njësiti.

7 PY. Faleminderit. Mjafton. A ju kujtohet ku ka qenë i
8 stacionuar njësiti Lisi i vendosur?

9 PË. Lisi duhet të ketë qenë i vendosur në fshatin Dobërdolan,
10 apo rreth tij. Aty diku.

11 PY. Po njësiti Guri?

12 PË. Njësiti Guri ka qenë në pjesën e Drenicës. Saktësisht nuk
13 e di si quhet vendbanimi apo ai territor, por ka qenë një pikë
14 diku e lartë që kishte komunikim herë pas here përmes
15 radiolidhjes, mes pikave.

16 PY. Faleminderit. Në provën P02009, në paragrafin 83 keni
17 folur për vendndodhjet e ndryshme të pikave të UÇK-së. A ju
18 kujtohet nëse ka pasur një pikë të UÇK-së në Graçac? [Shënim i
19 përkthyeses: Shqiptimi sipas Prokurores].

20 PË. Po në Greiçek ka qenë një pikë, po.

21 PY. A e dini kush e drejtonte?

22 PË. Atë pikë e ka drejtuar Jetullah Qarri.

23 PY. Si e kishte nofkën z. Qarri, në qoftë se ka pasur ndonjë
24 nofkë?

25 PË. Sipas asaj që unë e di, nofkën e ka pasur Guri.

1 PY. Dëshmitar, ju lutem thojeni edhe një herë ngadalë sepse
2 përkthyesit nuk e dëgjuan dot emrin.

3 PË. Po. Nofka e Jetullah Qarrit, sipas asaj që unë e di ka
4 qenë Guri.

5 PY. Faleminderit.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
7 ekran materialin SPOE00227441 deri në SPOE00227543, bashkë me
8 anglishten.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem përsërisni
10 numrin.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Materiali është
12 SPOE00227541, SPOE00227543.

13 PY. Z. Dëshmitar, me sa keni ju dijeni për organizimin e UÇK-
14 së në atë kohë, nga pikëpamja e njësive, a mund të na thoni
15 nëse emrat që shohim në këtë listë i përkisnin ndonjë prej
16 njësive?

17 PË. Ashtu siç kam dhënë përgjigje edhe më herët, në bazë të
18 mbiemrave, mund t'i kenë takuar njësitet Lumi, por jo që i njoh
19 i njoh në -- si emra të, personat përveç numrit 1.

20 PY. Përsëriteni edhe një herë ju lutem emrin e njësitetit.

21 PË. Thashë emrat në këtë listë mund t'i takojnë njësitetit
22 Pëllumbi, bazuar në mbiemrat, por jo që i njoh personat në
23 listë si emra të përveçëm.

24 PY. Thatë që njihnit emrin e parë? A bëhet fjalë për të
25 njëjtin Ferat Shala që drejtonte njësitetin Pëllumbi?

1 PË. Unë nuk kam dëgjuar që ka pasur ndonjë Ferat Shala
2 tjetër, dhe ky duhet të jetë. Po mendoj.

3 PY. Faleminderit. Te pika 19 shohim emrin Naser Krasniqi.
4 Bëhet fjalë për ju?

5 PË. Jo, nuk kam mundësi të bëhet fjalë për mua.

6 PY. Faleminderit.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj
8 pranimin e këtij dokumenti si pjesë e provave gjyqësore.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kundërshtojmë që të pranohet
11 dokumenti. Dëshmitarët tha që s'e ka parë ndonjëherë më
12 përpara këtë listë dhe ka identifikuar vetëm një emër nga
13 lista. Ne nuk e dimë kush e ka shkruar këtë dokument, sepse
14 dokumenti mbi të gjitha nuk mban asnjë datë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
16 tjetër?

17 Z. DIXON: [Përkthim] Mbështesim dhe ne të njëjtin
18 kundërshtim. Është një dokument prej një faqeje. Nuk e dimë as
19 prejardhjen, as cili është qëllimi i faqes. Nuk ka as një
20 ballinë dhe dëshmitari nuk po na jep asnjë detaj që të mund të
21 na ndihmojë.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dëshmitari ka dhënë informacionin
23 e mjaftueshëm. Tha që njeh emrin e parë, nuk njeh person
24 tjetër me të njëjtin emër dhe më herët konfirmoi se personi ka
25 qenë drejtues i njësitetit Llumi [Sipas përkthimit]. Ne mendojmë

1 se ka dhënë kontekstin e mjaftueshëm në mënyrë që të pranohet
2 dokumenti.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka relevancë
4 të mjaftueshme dhe për rrjedhojë do të pranohet. Kështu që
5 dokumenti SPOE00227543 [sipas përkthimit] pranohet dhe ju
6 lutem t'i jepni numrin përkatës.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
8 nderuar Gjykatës. Dokumenti do të marrë numrin e P023 [Sipas
9 përkthimit] dhe klasifikimi është konfidencial.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim]
11 PY. Dëshmitar, tani do të flasim për kohën që keni qenë në
12 Brigadën 121.

13 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Ju lutem vendosni në ekran
14 materialin SPOE00226323 dhe përkthimin në anglisht.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më duket se
16 kemi problem me transkriptimin. Nuk po punon?

17 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
18 këshillohen]

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të vazhdoj?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

22 PY. Z. Dëshmitar, përpara se t'ua tregoja unë dokumentin
23 javën e kaluar, ju e kishit parë ndonjë herë?

24 PË. Jo, nuk e kam parë më parë, deri javën e kaluar.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] E shohim më poshtë shqipen, te

1 pjesa e nënshkrimit? E lëmë kështu ju lutem.

2 PY. A e njihni nënshkrimin në këtë dokument?

3 PË. Ndonëse unë nuk jam ekspert i grafologjisë, por mund të
4 them që shkrimi është i Cerkin Dukollit, bazuar në një sërë
5 dokumentesh të tjera me të cilat kemi kooperuar brenda
6 brigadës.

7 PY. Faleminderit. Çfarë roli ka pasur Dukolli në Brigadën
8 121?

9 PË. Për periudhën që -- për periudhën që bazohet dokumenti,
10 ka qenë shef i S1-shit, ose i sektorit të personelit, apo
11 ndryshe kanë mund të quhen edhe ndihmës komandantë për -- i
12 personelit, i sektorit të personelit brenda Brigadës.

13 PY. Faleminderit. Shihni poshtë më të majtë. Këto inicialet:
14 ÇD, çfarë janë?

15 PË. Inicialet mendoj që janë [e pakuptueshme] të Cerkin
16 Dukollit, shkronja e parë e emrit dhe shkronja e parë e
17 mbiemrit.

18 PY. Faleminderit. Në tekstin e këtij telegrami shohim që i
19 është drejtuar një personi me "10". A e dini kush është ky?

20 PË. Ne në brigadë si "10" kemi pasur njohuri që këtë shifër
21 ose nofkë e mban z. Rexhep Selimi, nëse s'ka pasur edhe dikush
22 tjetër, që unë s'kam dëgjuar për ndonjë tjetër.

23 PY. Kur thoni në brigadë -- kur thoni në brigadë, e keni
24 fjalën e gjithë brigada, një pjesë e brigadës?

25 PË. Unë fjalën e kam për pjesën që i kemi takuar komandës së

1 brigadës, gjithashtu dhe një pjesë me të cilët kam pasur
2 rastin të punoj në policinë ushtarake.
3 PY. Me sa keni ju dijeni, a ka pasur anëtarë të tjerë të UÇK-
4 së që njiheshin me numra?

5 PË. Unë së paku mund t'i kujtoj edhe -- edhe dy, por nuk di
6 për të tjerë.

7 PY. Kush ishin këta të dy që ju mban i mend? Dy personat?

8 PË. Po, për shembull, z. Sokol Bashota mbante numrin 11. Z.
9 Kadri Veseli numrin 7. Numra të tjerë nuk më kujtohet që ka
10 pasur dikush.

11 PY. Faleminderit. e nga e dini ju këtë informacion për këto
12 dy numrat?

13 PË. Mendoj që për pjesën ku ne kemi vepruar, nuk ka qenë për
14 ne sekret. E kemi ditur, si komandë e Brigadës e kemi ditur.
15 Nuk e di deri ku ka mund të shtrihet informacioni, por ne e
16 kemi ditur. E kemi pas këtë informacion.

17 PY. Kur thoni "ne", kush është -- me kë - me -- për kë e keni
18 fjalën për emrin "ne".

19 PË. Fjalën e kam për personat që i kanë takuar komandës së
20 Brigadës 121.

21 PY. Faleminderit.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj
23 pranimin e këtij dokumenti.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
25 kundërshtime?

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi ndonjë kundërshtim por
2 nuk e kemi të qatë relevancën e këtij dokumenti.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përmbush
4 standardet minimale të Rregullës 138. Materiali ERN00226323
5 pranohet.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti
7 do të marrë numrin e provës P02014 dhe klasifikimi është
8 konfidencial.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ndërkohë po shoh që ka vajtur dhe
10 ora.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
12 për sot përfunduar. Do ri fillojmë nesër në orën 9.00 dhe ju
13 urojmë një mbrëmje të këndshme. Ju lutem mos diskutoni me
14 askënd jashtë Gjykatës për dëshminë tuaj.

15 DËSHMITARI: Faleminderit.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Përpara se sa ta mbarojmë, kam dy
18 aspekte.

19 Fillimisht, dua t'ju informoj për rendin që do ndjekim ne
20 për kundërpyetjet, çka do të thotë se do të fillojmë ne,
21 pastaj do të na -- pas nesh do t'i bëjë pyetjet avokati i z.
22 Veseli, më pas Avokati i z. Krasniqi, dhe më pas avokati i z.
23 Thaçi.

24 Gjithashtu kemi një paqartësi për një nga dokumentet në
25 listën e prezantimeve të Prokurorisë, i cili nuk ka qenë një

1 nga dokumentet për të cilin na ka njoftuar Prokuroria. Mund
2 t'i jap ERN-në Prokurorisë që të bëjë verifikimin përkatës.
3 Është materiali SPOE00226483. S'kemi marrë njoftim, pra, për
4 këtë dokument. Mund t'iu jap edhe numrin e plotë të paketës që
5 është SPOE00226490. Në të shkuarën, kur nuk e -- nuk kemi
6 marrë njoftim për dokumente të tilla, Prokuroria duhet të bëjë
7 të qartë cila është relevanca e dokumentit dhe për çfarë
8 qëllimi do ta përdorin dokumentin në fjalë. Kështu që do
9 luteshim që Prokuroria të na japë informacionin përkatës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni diçka
11 për të thënë?

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] E kemi përdorur në Shënimi
13 Përgatitor numër 2, por më lejoni ta verifikoj.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
15 Mund ta trajtojmë nesër paradite këtë.

16 Seanca ndërpritet këtu dhe rifillojmë nesër në orën 9.00.

17 --- Seanca mbyllet në orën 16.31

18

19

20

21

22

23

24

25